



Republika e Kosovës – Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs
Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova / Police Inspectorate of Kosovo



RAPORT VJETOR 2020



2020

Inspektorati Policor i Kosovës

©Të drejtat e autorit të Inspektoratit Policor të Kosovës

Teksti i këtij dokumenti mund të riprodhohet falas në çdo format ose medium, me kusht që të riprodhohet me saktësi dhe jo në një kontekst ndryshe nga se raportohet këtu.

Ky material duhet të njihet si e drejtë e autorit (Inspektoratit Policor të Kosovës) dhe dokumenti si titulli i specifikuar.

Kur është identifikuar materiali nga pala e tretë,leja nga mbajtësi i të drejtës së autorit duhet të kërkohet.

Çdo pyetje në lidhje me këtë publikim duhet të na dërgohet në:

Inspektorati Policor i Kosovës,

Rruga "Dëshmorëte Gollakut", p.n, Hajvali, Prishtinë, Tel:

038 200 19 691, +383 (0)38 521 201

E-mail: zimp.ipk@rks-gov.net

SHKURTESAT

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DBI	Divizioni për bashkëpunim dhe informim
DFSHP	Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
DH	Departamenti i Hetimeve (IPK)
DI	Departamenti i Inspektimeve
DIA	Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë
DMA	Departamenti për Menaxhimin e Ankesave
DMH	Drejtoria për Migrim dhe të Huaj
DMO	Drejtoria për Menaxhimin e Objekteve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DRK	Drejtoria Rajonale Kufitare
DKRR	Divizioni i Komunikacionit Rrugor
DHBVK	Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të Kaluarës
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
EVS	Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi
FRONTEX	The European Border and Coast Guard Agency
ICITAP	Internacional Criminal Investigative Training Assistance Program
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
NJKA	Njësia e Kontrollit të Autostradës
NJRKRR	Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PSO	Procedura Standarde e Operimit
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
SPK	Stacioni Policor Kufitar
SPMK	Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit
TI	Teknologjia Informative
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

PËRMBAJTJA

1.	RRETH NESH	6-6
2.	FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	7-7
3.	HYRJE.....	8-8
4.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9-9
5.	MENAXHIMI I ANKESAVE	11-15
6.	HETIMET PENALE	17-25
7.	INSPEKTIMET E STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE POLICORE.....	27-40
8.	MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, PROMOVIMI DHE BASHKËPUNIMI	41-46
9.	SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE.....	47-50

1. RRETH NESH

Historik i shkurtër

IPK është mekanizëm i pavarur mbikëqyrës, i ndarë nga Policia e Kosovës dhe funksionon sipas modelit të vendeve perëndimore që aplikojnë standarde të larta ndërkombëtare të kontrollit policor dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Është themeluar në korrik të vitit 2006 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2005/54 dhe Urdhëresës Administrative nr.2006/9, si Agjencion Ekzekutiv në kuadër të MPB-së. Bazuar në këto akte, ka funksionuar deri me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 03/L-136 për IPK-në, të miratuar në vitin 2008. Më pas, për shkak të ndryshimit të mandatit ligjor në fushën e hetimeve, nga viti 2010, IPK-ja funksionon bazuar në Ligjin nr. 03/L-231, i cili ka hyrë në fuqi më 1 Dhjetor 2010.

Fushëveprimi

Objekt i veprimtarisë së IPK-së është:

1. Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të

detyrës ose jashtë saj;

2. Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi;

3. Hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv;

4. Kur ekziston dyshimi i bazuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka kryer shkelje

disiplinore, Kryeministri mund të autorizon Inspektoratin Policor të Kosovës për zhvillim të hetimeve disiplinore. Inspektorati Policor i Kosovës pas përfundimit të hetimeve disiplinore i raporton Kryeministrit për të gjeturat;

5. Pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe cilat do t'i referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve përgjegjëse.

Misioni

Misioni i IPK-së është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.

Vizioni

IPK synon fuqizimin e rolit të tij në funksion të rritjes së integritetit, profesionalizmit dhe ofrimit të shërbimeve profesionale dhe etike për qytetarët.

Parimet tona

Si një agjenci e përkushtuar për t'iu shërbyer interesave të të gjithë qytetarëve, IPK-ja udhëhiqet nga vlerat, si: përgjegjshmëria, profesionalizmi, objektiviteti, paanshmëria, mosdiskriminimi, transparenca, efikasiteti dhe efektiviteti.

2. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Sfidat dhe vështirësitë e krijuara si rezultat i Pandemisë Covid-19, natyrisht që nuk e kanë kursyer as Inspektoratin Policor të Kosovës. Prandaj në fillim duhet të falenderoj secilin punonjës në IPK. Falë punës dhe angazhimit të tyre të pakursyer, Inspektorati Policor i Kosovës në vitin 2020 jo vetëm që ka dhënë kontribut të rëndësishëm për luftimin e pandemisë Covid-19 por edhe janë evidentuar suksese të konsiderueshme në përmbushjen e misionit të IPK.



Kushtrim Hodaj - Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së

Inspektorati Policor i Kosovës ka arritur të zbatoj plotësisht të gjitha detyrimet e përcaktuara me Ligjin

kundër Covid-19 si dhe masat tjera qeveritare për luftimin e pandemisë. Rrjedhimisht të gjitha aktivitetet e zyrtarëve në IPK janë përshtatur me rekomandimet e institucioneve shëndetësore për mbrojtje nga Covid-19.

Gjatë vitit 2020 në IPK janë pranuar 15% për më shumë ankesa se në vitin 2019 nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Sipas analizave të Inspektoratit Policor të Kosovës, rritja e numrit të ankesave në 2020 kundër punonjësve të Policisë së Kosovës është manifestim i së paku dy (2) faktorëve kryesor.

Në njërin anë rritja e numrit të ankesave kundër punonjësve policor mund të shpjegohet si rritje paralele me rritjen e punës nga Policisë e Kosovës gjatë pandemisë Covid-19. Në anën tjetër nuk ka asnjë dyshim se rritja e numrit të ankesave në IPK ka të bëjë edhe me rritjen e besimit të qytetarëve në punën, profesionalizmin dhe transparencën e Inspektoratit Policor të Kosovës. Prandaj Inspektorati Policor i Kosovës është shumë mirënjohës ndaj të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim, të cilët kanë bashkëpunuar ngushtë me Inspektoratin Policor të Kosovës dhe kanë dhënë kontributin kryesor për të garantuar një shërbim profesional, demokratik dhe transparent të Policisë së Kosovës.

Sa i përket ankesave kundër punonjësve policor, duhet shtuar se Inspektorati Policor i Kosovës në vazhdimësi ka promovuar mundësinë e paraqitjes së ankesave në mënyrë elektronike për të zvogëluar në maksimum mundësitë për infektim me Covid-19.

Rrjedhimisht gjatë vitit 2020 është evidentuar një rritje e konsiderueshme e numrit të ankesave elektronike në krahasim me vitin 2019. Hetuesit dhe inspektorët në IPK kanë dëshmuar nivelin më të lartë të profesionalizmit në punë edhe gjatë vitit 2020. Në njërin anë falë punës së hetuesve në IPK në vitin 2020 është evidentuar një rritje e numrit të kallëzimeve penale kundër punonjësve policor për vepra të ndryshme penale. Në anën tjetër inspektorët kanë përfunduar me sukses të lartë gjithësej shtatë (7) inspektime në fusha të ndryshme policore nga të cilat kanë derivuar dyzet e gjashtë (46) rekomandime për Policinë e Kosovës.

Duhet theksuar se krahas përmbushjes me sukses të detyrave dhe përgjegjësisë të zakonshme ligjore, Inspektorati Policor i Kosovës që nga fillimi i pandemisë ka implementuar plan operativ për monitorimin e masave për luftimin e Covid-19 nga Policia e Kosovës.

Si rezultate të kësaj, janë realizuar me sukses aktivitete të shumta në gjithë territorin e Republikës së Kosovës përmes të cilave është parandaluar dhe luftuar Covid-19. Inspektorati Policor i Kosovës mbetet i përkushtuar për të përmbushur në mënyrë profesionale dhe transparente të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e veta ligjore, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë qytetarët e vendit dhe institucionet tjera kompetente.

3. HYRJE

Ky është Raport përmbledhës i punës së IPK-së për periudhën Janar - Dhjetor 2020, i cili përmban aktivitete dhe të arritura të dokumentuara. Raporti i këtij viti pasqyron sfidat dhe aktivitetet e ndërmarra bazuar në kompetencat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe të arriturat kryesore gjatë kësaj periudhe.

Në drejtim të ngritjes së transparencës dhe ofrimit të informacionit për qytetarëve mbi punën që bëjmë, IPK-ja praktikon që të publikojë një dokument përmbledhës në standardin e një Raporti të rregullt vjetor, ku pasqyrohen sfidat dhe angazhimet tona në përmbushje të përgjegjësisë dhe misionit ligjor.

IPK vlerëson se nga viti në vit puna jonë vazhdon të jetë më cilësore dhe këtë e dëshmojnë rezultatet tejet mbresëlënëse. Rezultatet konsiderohen se janë të përbashkëta, ngase pjesë të suksesit tonë bartin dhe qytetarët që ofruan një bashkëpunim në denoncimin e shkeljeve nga radhët policore, por edhe partnerët tanë që na mbështetën në këtë rrugëtim.

Përgjegjësitë dhe detyrat që lidhen me funksionet e saj, IPK i ka të ndara në departamente. Bazuar në Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për punonjësit e IPK-së, agjencia jonë është e strukturuar në pesë (5) departamente, prej të cilave, katër (4) janë operative dhe një (1) mbështetës. Roli i secilit departament është i shtjelluar në brendësi të këtij Raporti.

Raporti i këtij viti është i ndarë në disa kapituj, ku pasqyrohen aktivitetet e departamenteve, rezultatet e punës dhe sfidat në arritjen e rezultateve.

IPK-ja do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në ngritjen e cilësisë së shërbimit, në përmbushje të mandateve që dalin nga Ligji për IPK-në, në drejtim të sigurimit që Policia e vendit tonë të zhvillohet si forcë e përgjegjshme, profesionale dhe demokratike. Ky mision konsiderohet i rëndësishëm për ne, andaj dhe interesi ynë është që Policia të zhvillohet krahas standardeve ndërkombëtare.

Një ndër angazhimet e rëndësishme të IPK-së gjatë vitit 2020 ishte moitorimi nga afër i policisë lidhur me zbatimin e vendimeve mbi zbatimin e masave parandaluese kundër përhapjes së Covid-19.

Synimi i këtij moitorimi ishte që të kontribuohet në ngritjen e përgjegjësisë në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme policore dhe të nxis seriozitetin e strukturës policore që të ndërmarrë hapat efikas në menaxhimin e situatës.

Bazuar në Planet operative të moitorimit, ky aktivitet është realizuar në disa faza gjatë vitit 2020.

Moitorimi është fokusuar në kapacitetet policore të angazhuara, respektimin e zbatimit të masave të Qeverisë, si dhe bashkëpunimin me akterët tjerë të përfshirë në menaxhimin e situatës së krijuar nga Covid-19.

Në përfundim të kësaj hyrjeje, vlerësojmë se edhe pse kemi ofruar disa dritare të informimit të qytetarëve mbi angazhimet tona, ne zotohemi se edhe në të ardhmen do të vazhdojmë t'iu ofrojmë informacionin me kohë dhe për kureshtjen tuaj, siç vazhdon të jetë edhe kjo praktikë e raportimit e shprehur përmes këtij Raporti.

4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë përmbledhje janë pasqyruar informata të dala nga analizat e kryera mbi performancën e organizatës në të gjitha drejtimet, bazuar në mandatet e përcaktuara me Ligjin për IPK-në.

Jemi angazhuar që të rrisim besimin e qytetarëve në sistemin e trajtimit të ankesave:

- Kemi administruar **1.658** ankesa, të pranuar në mënyra të ndryshme;
- **35%** të tyre i orientuam për hetim penal në Departamentin e Hetimit;
- Pjesën e mbetur prej **65%** i kemi orientuar për hetim disiplinor Divizionin e Hetimeve të Brendshme dhe Verifikimin e të Kaluarës në kuadër të Policisë së Kosovës.

Ne u angazhuam në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe keqmenaxhimit policor:

- Kemi hetuar **377** punonjës policor;
- Kemi ngritur **82** kallëzime penale ndaj të dyshuarve për vepra kriminale;
- Kemi arrestuar **38** punonjës dhe qytetarë nën dyshimin për përfshirje në krim;
- Kemi rekomanduar transferimin e tetë (**1**) punonjësi policor;
- Kemi rekomanduar suspendimin e **83** punonjësve policorë.

Përmes aktiviteteve tona ndihmuam në përmirësimin e policimit:

- Realizuam shtatë (**7**) inspektive të planifikuara dhe të jashtëzakonshme, me analiza të thella dhe përmbajtjesore lidhur me të gjitha fushat e menaxhimit;
- Kontrolluam **qindra** dosje administrative (penale, financiare, prokurimit, etj.) dhe realizuam dhjetëra intervista;
- Rekomanduam avancimin e punës, efikasitetit dhe performancës përmes dhënies së **46** rekomandimeve;
- Verifikuam përmbushjen e rekomandimeve nga fushat e ndryshme të inspektuara më parë.

Ne u angazhuam në sensibilizimin e qytetarëve për të shprehur përkushtimin tonë për trajtimin e shqetësimeve të tyre:

- Publikuam mbi **50** komunikata,
- Ofruam informacione për medie në mbi **300** kërkesa të tyre;
- Realizuam shumë takime me qytetarë, forume të sigurisë, OJQ, institucione, etj.;
- Hartuam dokumente planifikuese dhe akte nënligjore;

5. MENAXHIMI I ANKESAVE

Departamenti i Menaxhimit të Ankesave (tutje si DMA) është ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së që ka për objekt të veprimtarisë: pranimin e të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimin dhe përcaktimin, se cilat nga to hetohen nga IPK dhe cilat do t'i referohen Policisë apo institucioneve përgjegjëse¹.

Qytetarët e vendit dhe ata të huaj mund të paraqesin ankesë në DMA lidhur me pretendimet e tyre se ndonjë nga pjesëtarët e Policisë ka kryer detyrat në kundërshtim me rregullat e sjelljes.

Ankesë konsiderohet çdo parashtrësë e drejtuar në IPK nga ndonjë individ ose grupi interesit, me të cilën shprehen shqetësimet lidhur me sjelljen devijante të punonjësve policorë apo kur parashtrësja ka të bëjë me standardet policore apo udhëzimet operative.

Detyrat dhe përgjegjësitë e DMA-së janë:

- të sigurojë realizimin e politikave e procedurave të organizatës në menaxhimin e ankesave dhe të informacionit të disponueshëm mbi dyshimet për përfshirje të punonjësve të Policisë në vepra të kundërligjshme;
- të sigurojë mbajtjen e evidencave/regjistrave për ankesat dhe mbi bazën e tyre nxjerrë statistika me të dhëna për raportime;
- të sigurojë që informatat që posedon IPK-ja mbahen/ruhen sipas ligjeve përkatëse;
- të sigurojë që ankesat trajtohen duke u bazuar në parimet e përcaktuara me Ligjin e IPK-së².

Bazuar në Rregulloren mbi organizimin e brendshëm, DMA-ja përbëhet nga dy divizione:

- Divizioni i Trajtimit të Ankesave;
- Divizioni i Administrimit të Lëndëve.

DMA ka të punësuar tetë (8) punonjës.

DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT TË ANKESAVE

Jemi angazhuar që të rrisim besimin e qytetarëve në sistemin e trajtimit të ankesave:

- Kemi administruar 1.658 ankesa përmes mënyrave të ndryshme (mesatarja 138 ankesa në muaj);
- Ngritje mbi 15% të numrit të ankesave krahasuar me një vit më parë dhe rezulton si shifër më e larta në 10 vitet e fundit;
- Në tre vitet e fundit ankuesit e gjinisë femërore janë ngritur për 2 deri 3%.
- 35% të tyre i orientuam për hetim penal në Departamentin e Hetimit;
- Pjesën e mbetur prej 65% i kemi orientuar për hetim disiplinor në Divizionin e Standardeve Profesionale të Policisë.
- Viti 2020 ka qenë një vit tjetër produktiv për Departamentin e Menaxhimit të Ankesave, duke adresuar shqetësimet e ankuesve.

¹ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).


² Neni 15 i Rregullores (MPB) nr. 01/2017 (Departamenti i Menaxhimit të Ankesave).

Pranimi i ankesave

Departamenti i Menaxhimit të Ankesave gjatë vitit 2020 ka pranuar dhe administruar gjithsej 1.658 ankesa, prej të cilave 17 informata. Nëse shohim historikun e statistikave për numrin e ankesave për tri (3) vitet e fundit që lidhen me mandatet që dalin nga Ligji i IPK-së, shohim se viti i fundit ka shënuar shifrën më të lartë të numrit të ankesave të pranuar nga qytetarët e vendit duke evidentuar ngritje e numrit të përgjithshëm të ankesave për 15%.

Ngritja e numrit të ankesave është rezultat i ngritjes së besueshmërisë së qytetarëve tek organizata jonë, por edhe i punës që bëjnë punonjësit tanë, qoftë në rrafshin e përmbushjes së mandateve, apo në promovimin e vlerave tona dhe sensibilizimin e qytetarëve për punën që bëjmë.

Vlen të ceket se nga muaji mars e deri në fund të vitit, vendi ynë është përballuar me pandeminë e shkaktuar nga virusi Covid-19 dhe për këtë arsye Qeveria e Republikës së Kosovës ka zbatuar disa masa për parandalimin e kësaj pandemie, siç janë vendosja e maskave, kufizimi i lirisë së lëvizjes dhe masa të tjera. Kjo ka bërë që një numër i qytetarëve të parashtrajnë ankesa për shkak të gjobave të shqiptuara nga ana e Policisë së Kosovës, duke shprehur mospajtime dhe ankesa të ndryshme për veprimet e policisë. Pra, edhe kjo rrethanë është njëra prej arsyeve të ngritjes së numrit të ankesave.



Mënyra e pranimi të ankesave

Sipas akteve ligjore dhe nënligjore të IPK-së, qytetarët kanë mundësi të ndryshme që të procedojnë ankesat e tyre. Nëse i referohemi statistikave të viteve të fundit, shihet se qytetarët më së shumti preferojnë të dorëzojnë fizikisht ankesat e tyre. Dorëzimi i ankesave në formë elektronike përmes internetit dhe dorëzimi përmes postës po ashtu ndër mënyrat më të shpeshta që preferojnë qytetarët.

Gjatë vitit 2020, rreth 29% e ankesave të qytetarëve janë pranuar fizikisht në IPK, 25% e tyre kanë ardhur përmes postës elektronike, 17% kanë ardhur përmes postës dhe numri prej 15% kanë ardhur nga Policia e Kosovës, shih tabelën nr. 1 si më poshtë:

Nr.	Mënyrat e parashtrimit të ankesave në IPK	Numri	Përqindja
1	Ankesa të pranuar në formë elektronike	415	25.03%
2	Ankesat e pranuar fizikisht në IPK	471	29.31%
3	Ankesa të pranuar në zyrat rajonale të IPK-së	58	3.50%
4	Përmes kutive të ankesave	3	0.18%
5	Ankesa anonime	9	0.54%
6	Informatat e pranuar në IPK	17	1.03%
7	Ankesa (inicime) nga Departamenti Hetimeve	72	4.34%
8	Ankesa të pranuar përmes postës	298	17.97%
9	Inicime nga Departamenti i Menaxhimit të Ankesave	31	1.87%
10	Ankesa të pranuar përmes institucioneve tjera	39	2.35%
11	Ankesa të pranuar përmes Policisë së Kosovës	108	6.51%
12	Inicime të brendshme nga Policia e Kosovës	137	8.26%
	Gjithsej	1.658	100%

Bazuar në të dhënat nga tabela më lartë, del se 1.365 ankesa (raste) apo 82.33% janë pranuar drejtpërdrejtë nga IPK-ja (renditja sipas numrave rendor 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9), derisa përmes institucioneve publike dhe OJQ - ve janë pranuar 293 ankesa (raste) apo 17.67% e numrit të përgjithshëm (renditja sipas numrave rendor 10, 11 dhe 12). Vërehet se rreth $\frac{3}{4}$ e numrit të përgjithshëm të ankesave pranohen drejtpërdrejtë nga IPK-ja, derisa $\frac{1}{4}$ e numrit të ankesave pranohen përmes institucioneve tjera dhe OJQ-ve.

Përkatësia gjinore e ankuesve

Sipas të dhënave të Departamentit të Menaxhimit të Ankesave, në vitin 2020, 1.288 ankesa janë adresuar nga persona të gjinisë mashkullore, derisa 149 sosh nga persona të gjinisë femërore. Për pjesën e mbetur prej 221 ankesave, nuk ka qenë e mundur të dihet gjinia, për shkak të mënyrës që është përzgjedhur të ushtrohet ankesa dhe këtu hyjnë rastet e cilësuar si inicimet sipas detyrës zyrtare nga DMA-ja, inicimet e brendshme, ankesat anonime si dhe ankesat që kanë ardhur nga institucionet tjera. Bazuar në të dhënat nga DMA-ja vërehet se në tre vitet e fundit, përqindja e femrave që kanë ushtruar ankesë është përafërt. Vlerësohet se kjo është rezultat i vetëdijesimit të personave të gjinisë femërore për të drejtën e tyre për të ushtruar ankesë kur vlerësojnë se kanë qenë subjekt që u janë shkelur të drejtat apo kur punonjësit policor në raport me to kanë kryer ndonjë shkelje (shih tabelën nr. 2):

Nr.	Ankuesit sipas gjinisë	2018	%	2019	%	2020	%
1	Meshkuj	1.032	72.7	1.090	75.7	1.288	77.68
2	Femra	161	11.4	155	10.8	149	8.99
3	E panjohur	226	15.9	194	13.5	221	13.33
	Gjithsej	1.419	100	1.439	100	1.439	100

Përkatësia etnike e ankuesve

Sipas të dhënave të Departamentit të Menaxhimit të Ankesave, në vitin 2020, 1.379 ankesa janë adresuar nga persona të përkatësisë shqiptare, 51 sosh nga persona të përkatësisë serbe, 4 nga persona të përkatësisë boshnjake dhe 3 ankesa nga shtetas të huaj.

Në totalin prej 1.658 ankesave, për 221 ankesa e pranuar në IPK, nuk dihet përkatësia e ankuesve dhe lidhen inicimet e brendshme, ankesat anonime si dhe ankesat që kanë ardhur nga institucionet tjera.

Bazuar në të dhënat zyrtare të DMA-së vërehet se IPK gëzon besueshmëri nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Besohet se kësaj i ka kontribuar edhe organizimi i fushatave të vetëdijesimit qytetar në disa lokalitete ku jetojnë pjesëtarë të pakicave, të cilët kanë pasur mundësi të njihen me punën që bën agjencia dhe mundësitë që ofron bashkëpunimi në trajtimin e shqetësimeve të tyre.

Analiza dhe trendet e ankuesve sipas etnive që kanë ushtruar ankesa në IPK për 3 vitet e fundit paraqitet në tabelën nr.3 si më poshtë:

Nr.	Ankuesit sipas gjinisë	2018	%	2019	%	2020	%
1	Shqiptar	1.111	78.3	1.149	79.8	1379	83.17
2	Serb	65	4.6	74	5.1	51	3.08
3	Turq	3	0.2	2	0.1	0	0.0
4	Boshnjak	9	0.6	13	1.0	4	0.24
5	RAE	1	0.1	2	0.1	0	0.0
6	Të tjerë të huaj	4	0.3	5	0.4	3	0.18
7	E panjohur	226	15.9	194	13.5	221	13.33
	Gjithsej	1.419	100	1.439	100	1.658	100

Ngarkesa mujore me ankesa

Muaji më i ngarkuar me numër të ankesave përgjatë vitit 2020 ka qenë muaji dhjetor, në të cilin janë regjistruar 198 ankesa apo 11.94% e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar gjatë vitit. Muaji prill ka qenë muaji më pak i ngarkuar me më së paku ankesa të pranuar gjatë këtij viti, ku numri ishte 84 ankesa apo 5.07% e numrit të përgjithshëm të ankesave (shih tabelën nr. 4).

Tabela nr. 4 - Të dhëna përmblledhëse mbi shpërndarjen e ankesave sipas muajve (2018-2020)							
Nr.	Muaji	2018	%	2019	%	2020	%
1	Janar	97	6.84	87	6.05	108	6.51
2	Shkurt	117	8.25	103	7.16	123	7.42
3	Mars	112	7.89	113	7.85	129	7.78
4	Prill	113	7.96	121	8.41	84	5.07
5	Maj	130	9.16	101	7.02	102	6.15
6	Qershor	99	6.98	112	7.78	125	7.54
7	Korrik	116	8.17	134	9.31	120	7.24
8	Gusht	158	11.13	139	9.66	159	9.59
9	Shtator	124	8.74	120	8.34	172	10.37
10	Tetor	112	7.89	153	10.63	176	10.62
11	Nëntor	141	9.94	138	9.59	162	9.77
12	Dhjetor	100	7.08	118	8.20	198	11.94
	Gjithsej	1.419	100	1.439	100	1.658	100

Numri i ankesave në raport me drejtoritë rajonale policore

Të dhënat e administruara nga DMA mundësojnë të kuptojmë edhe drejtoritë policore për punonjësit e të cilave ka pasur ankesa të qytetarëve.

Sipas të dhënave, ankesat më të shumta janë adresuar për punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Prishtinës dhe arrijnë në 44% të numrit të përgjithshëm të ankesave. Ndërsa më pak të atakuar mbesin Drejtoritë Rajonale të Policisë Kufitare Lindja dhe Perëndimi (shih tabelën nr. 5) .


Tabela nr. 5-Të dhëna përmblledhëse mbi shpërndarjen e ankesave sipas rajoneve policore gjatë			
Nr.	Drejtoritë Rajonale Policore	Numri i ankesave	Përqindja
1	DRP-Prishtinë	729	43.97
2	DRP-Pejë	151	9.11
3	DRP-Ferizaj	138	8.32
4	DRP-Prizren	159	9.59
5	DRP-Gjilan	119	7.18
6	DRP-Mitrovicë Jugu	115	6.94
7	DRP-Mitrovicë Veriu	80	4.83
8	DRP-Gjakovë	120	7.24
9	DRPK-Veriu	23	1.39
10	DRPK-Lindja	8	0.48
11	DRPK-Perëndimi	12	0.72
12	I palokalizuar	4	0.24
	Gjithsej	1.658	100%

Kualifikimi i ankesave

Gjatë vitit 2020, 574 ankesa apo 34.62% të numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar në IPK janë kualifikuar si ankesa që përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policor në vepra penale. Këto ankesa janë proceduar në Departamentin e Hetimeve të IPK-së për trajtim/hetim të mëtejshëm.

1071 ankesa apo 64.60% e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar në IPK janë kualifikuar se përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policor në shkelje disiplinore, dhe të njëjtat janë proceduar në Divizionin e Hetimeve të Brendshme dhe Verifikimin e të Kaluarës në kuadër të Policisë së Kosovës. Janë evidentuar 4 raste kur ankesat janë proceduar në institucionet tjera përgjegjëse (0.24%).

Sipas analizave të bëra, afërsisht 1/3 e ankesave të pranuar janë kualifikuar se përmbajnë elemente të veprave penale, derisa 2/3 e ankesave janë kualifikuar se përmbajnë elemente të shkeljeve disiplinore (shih diagramin nr.2 si më poshtë). Gjatë këtij viti janë evidentuar 6 raste apo 0.36% që ankesat të jenë proceduar në Departamentin e Hetimeve për t'u trajtuar për shkelje disiplinore konform mandatin ligjor, si dhe 1 ankesë (apo 0.06 %) është proceduar në Departamentin e Inspektimeve (shih diagramin nr.2 si më poshtë).



Bazuar në kualifikimin fillestar të ankesave, prej 574 sosh të kualifikuara me elemente penale, pesë ankesat më të shpeshta të raportuara në IPK kanë qenë për:

1. Keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar;
2. Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike;
3. Lëndimi trupor;
4. Manipulim me prova, dhe
5. Kansoja.

Ndërsa, ankesat të cilat janë kualifikuara me elemente të shkeljeve disiplinore (të rënda dhe të lehta) të cilat janë dërguar në Drejtorinë për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës (DHBVK) – PK janë të ndryshme por më e shpeshta për sjellje diskredituese.

6. HETIMET PENALE

Departamenti i Hetimeve është një ndarje organizative në kuadër të struktues së organizimit të IPK-së dhe funksionon që nga viti 2007.

Objektivë e vprimtarisë së Departamentit të Hetimeve është: parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit së detyrës ose jashtë saj; hetimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë; hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policorë të nivelit të lartë ekzekutive etj.³

Departamenti i Hetimeve është një ndarje organizative në kuadër të struktues së organizimit të IPK-së dhe funksionon që nga viti 2007.

Objektivë e vprimtarisë së Departamentit të Hetimeve është: parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit së detyrës ose jashtë saj; hetimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë; etj.⁴

Përgjegjësitë (detyrat) e Departamentit janë: kryen hetime penale si dhe disiplinore ndaj punonjësve të Policisë; zbaton masat e fshehta hetimore në funksion të fushëveprimit, të autorizuara nga autoriteti kompetent; zbaton metoda apo teknika të ligjshme për të zhvilluar kapacitetin proaktiv në ruajtjen e etikës dhe integritetit, në kuadër të standardeve të larta profesionale policore; bashkëpunon me Prokurorinë në fushën e hetimeve dhe shfrytëzon burime të ligjshme të informacionit për nevoja operative; nxjerrë raporte mbi rrjedhën e hetimeve të zhvilluara dhe kallëzime penale; ndërmer veprime të nevojshme ligjore për të siguruar dhe vlerësuar informatat inteligjente; siguron mbështetje teknike në funksion të hetimeve (përdorë pajisje teknike në funksion të realizimit të masave të veçanta, siguron dhe trajton dëshmi nga vend-ngjarja)⁵.

Hetuesit e zhvillojnë aktivitetin e tyre në tetë (8) divizione. Departamenti ka të punësuar 46 punonjës (Udhëheqës i Departamentit, udhëheqës të divizioneve dhe hetues).

DEPARTAMENTI I HETIMEVE

Ne u angazhuam në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe keqmenaxhimit policor:

- Kemi hetuar 208 punonjës policor;
- Kemi ngritur 82 kallëzime penale ndaj të dyshuarve për vepra kriminale;
- Kemi arrestuar 38 punonjës dhe qytetarë me dyshimin për përfshirje në aktivitete të kundërligjshme;
- Kemi rekomanduar suspendimin e 83 punonjësve policorë.
- Kemi rekomanduar transferimin e 1 punonjësi policorë;


³ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

⁴ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

⁵ Neni 6 i Rregullores (MPB) nr.01/2017 (Departamenti i Hetimeve).

Raporti përmbledhës për hetime penale përmban aktivitete të realizuara në suaza të detyrave dhe përgjegjësi që rrjedhin nga dispozitat e përcaktuara në Ligjin për IPK, në veçanti për Departamentin e Hetimit, si dhe të dhënat që posedon si dhe të dhënat e gjeneruara. Bazuar në të dhënat nga evidencat zyrtare, gjatë vitit 2020, subjekti hetimit nga IPK kanë qenë gjithsej 208 punonjës policor, shprehur në përqindje vetëm 2.3% e numrit të përgjithshëm të punonjësve policorë janë hetuar me dyshimin se kanë kryer vepra penale.

Diagrami nr.3



Viti 2020 konsiderohet një vit i suksesshëm për DH-në bazuar në të dhënat lidhur me numrin e rasteve të trajtuara, numrin kallëzimeve penale, numrin e të arrestuarve, të suspenduarve etj.

Në vitin 2020, D.H-ja ka pranuar 575 raste përmes DMA-së, ndërsa të bartura nga viti 2019 në vitin 2020 kanë qenë gjithsej 143 raste të cilat janë konsideruar si raste nën hetim paraprak.

Gjithsej D.H ka trajtuar gjithsej 718 raste duke përfshirë rastet e bartura nga viti paraprak si dhe rastet e pranuar në këtë vit (shih tabelën nr.6 si më poshtë).

Kategorizimi i rasteve dhe hapat procedural	
Gjithësej në punë	718
Të regjistruara (2020)	575
Të bartura nga viti paraprak	143


Sa i përket 143 rasteve që janë bartur nga viti 2019 si raste në hetim paraprakë, trajtimi i tyre është bërë si në vijim:

- 39 raste (27%) janë dërguar në DHBVK për hetim të mëtejshëm disiplinor;
- 20 raste (14%) janë dorëzuar në prokuroritë kompetente;
- 84 raste (59%) janë në proces të hetimit preliminar dhe barten në vitin 2021.

Nga 718 raste të pranuar në vitin 2020, pas trajtimit të tyre, në mungesë të elementeve të veprës penale 212 raste janë proceduar në DHBVK për hetim të mëtutjeshëm administrativ- disiplinor, ndërsa 126 raste janë trajtuar në aspektin penal. 6 raste janë trajtuar në aspektin disiplinor bazuar në ligjin për IPK⁶. 374 raste kanë mbetur në hetim preliminar e që janë bartur në vitin 2021.


⁶ LIGJI Nr. 03/L-231, Neni 2, paragrafi 1.3, 1.4 dhe 14.5

Të gjitha të dhënat e lartëcekura janë të pasqyruara në diagramin si në vijim:



IPK në vitin 2020 ka regjistruar 126 raste me numër penal përderisa në Prokurorinë e Shtetit ka proceduar 135 raste (duke llogaritur edhe disa nga rastet e bartura nga viti paraprak).


Diagrami në vazhdim pasqyron statusin e rasteve penale të trajtuara si dhe trendet e krahasuara me dy vitet paraprake:



IPK gjatë vitit 2020 ka proceduar me kallëzim penal në Prokurorinë e Shtetit gjithsej 82 raste, me raport të veçantë gjithsejtë 37 raste kurse me me raport informues në prokurori janë proceduar 16 raste.


Bazuar në diagramin në vijim shihet se numri i kallëzimeve penale është i ngjashëm në tri vitet e fundit, shihet një ngritje e lehtë e dërgimit të rasteve me raport të veçantë ndërsa ka rënie të dukshme të dërgimit të rasteve me raport informues⁷.

⁷ Arsyet e trendit të rritjes në vitin 2019 është se në këtë vit janë proceduar me raporte informuese sipas



Si rezultat i proceseve hetimore dhe angazhimeve të personelit hetimor, gjithmonë kur janë plotësuar kushtet ligjore, DH-ja ka kryer arrestime të të dyshuarve për përfshirje në vepra penale, duke vënë në zbatim dispozitat e përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. DH-ja, për interes të hetimit rekomandon edhe masa administrative hetimore si: suspendimin dhe transferimin e zyrtarëve policorë, duke vënë në zbatim dispozitat e parapara në Ligjin për IPK-në.


IPK-ja gjatë vitit 2020, ka realizuar gjithsej 32 arrestime të punonjësve të PK-së dhe 6 qytetarë të dyshuar (të cilët kanë qenë të përfshirë në veprimtari penale në rastet ku janë hetuar punonjësit e PK së) si dhe ka rekomanduar 83 suspendime dhe një transfer. Në diagramin në vijim janë paraqitur numri i zyrtarëve të arrestuar, suspenduar dhe transferuar për tre vitet e fundit.



Duke ju referuar rasteve penale të trajtuara nga IPK gjatë vitit 2020, pesë (5) veprat penale më të shpeshta që janë hetuar gjatë vitit 2020 janë të pasqyruara në diagramin si në vijim:

udhëzimeve të Prokurorisë së Shtetit rasti i ashtuqajtur “invalidët e luftës” ku të hetuar kanë qenë 141 punonjës të PK-së.

Diagrami nr. 8: Pesë veprat penale më të shpeshta të hetuara nga IPK në 2020




Gjatë tre viteve të fundit (2018-2020) pothuajse të njëjtat vepra kanë prirë në listën e pesë veprave penale. Ka trend të ngritjes së vazhdueshme për veprat penale “Lëndim i lehtë trupor”, “Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike” dhe veprës penale “Sulm”.

Të dhënat zyrtare tregojnë se te vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” është shënuar një ngritje krahasuar me vitin 2019, ndësa rënie krahasur me vitin 2018. Kurse te vepra penale “Dhuna në familje” është shënuar një rënie e lehtë, krahasur me vitin paraprak.

Të dhënat e lartëcekura janë të paraqitura në diagramin si më poshtë:

Diagrami nr.9: Kategorizimi i pesë (5) veprave më të shpeshta penale



Gjatë vitit 2020, DH ka qenë e përkushtuar në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi, në parandalimin si dhe luftimin e veprimtarive penale të kryer nga punonjësit e Policisë së Kosovës dhe qytetarëve të prëfshirë me punonjësit e PK së, e me theks të veçantë në luftimin e veprimtarisë korruptive. Pasqyra e veprave me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare krahasuar edhe me dy vitet paraprake është paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela nr. 7: Pasqyra e veprave me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare				
Nr.	Lloji i veprës penale	2018	2019	2020
1	Keqpërdorimi pozitivës po autoritetit zyrtar	27	26	28
2	Falsifikim i dokumentit zyrtar	4	1	0
3	Marrje e ryshfetit	1	4	3
4	Ushtrimi ndikimit	1	1	1
5	Zbulimi fshehtësisë zyrtare	3	1	0
5	Dhënie e ryshfetit	0	0	0
6	Përvetësim në detyrë	0	1	0
7	Konflikti interesit	0	1	0
8	Keqpërdorimi informatës zyrtare	0	1	0
	Gjithsej	36	36	32

Tabela nr. 8 në vijim pasqyron të dhënat e veprave penale të trajtuara nga IPK gjatë vitit 2020 të ndara në kapituj duke ju referuar Kodit Penal të Republikës së Kosovës:

Lloji i veprave penale	Nr i veprave
Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së republikës së Kosovës (XIV)	
Neni 141 Nxitja e përçarjës dhe mosdurimit	1
Veprat penale kundër jetës dhe trupit(XVI)	
Neni 178 Vrasja	2
Neni 179 Vrasja e rëndë	1
Neni 181 Kanosja	7
Neni 182 Ngacmimi	3
Neni 184 Sulmi	9
Neni 185 Lëndimi i lehtë trupor	30
Neni 186 Lëndimi i rëndë trupor	1
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut (XVII)	
Neni 198 Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike	23
Veprat penale kundër integriteti seksual (XX)	
Neni 227 Dhunimi	1
Neni 230 Degradimi i integritetit seksual	1
Veprat penale kundër martesës dhe familjes (XXI)	
Neni 248 Dhuna në familje	9
Veprat penale kundër shëndetit publik (XXII)	
Neni 250 Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë	2
Veprat penale kundër ekonomisë (XXV)	
Neni 294 Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm	1
Neni 299 Tregtia e ndaluar	1
Veprat penale kundër pasurisë (XXVI)	
Neni 313 Vjedhja	1
Neni 321 Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë	2
Neni 329 Shantazhi	1
Neni 330 Keqpërdorimi i besimit	1
Neni 331 Fajdeja	1
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithëshme të njerëzve dhe pasurisë	

(XXVIII)	
Neni 356 Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm	6
Veprat penale të armëve (XXVIX)	
Neni 364 Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse	1
Neni 366 Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	2
Neni 367 Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik (XXX)	
Neni 370 Rrezikimi i trafikut publik	3
Neni 371 Ngasja në gjendje të pa aftë apo të dehur	2
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike (XXXI)	
Neni 378 Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre	1
Neni 389 Manipulimi me prova	4
Neni 398 Mundësimi i arratisjes së personave të privuar nga liria	2
Veprat penale kundër rendit publik (XXXII)	
Neni 412 Pengimi i ceremonive fetare	1
Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare (XXXIII)	
Neni 414 Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	28
Neni 421 Marrja e ryshfetit	3
Neni 424 Ushtrimi i ndikimit	1

Policia e Kosovës ka gjithsej 9147 punonjës, nga të cilët 8155 janë zyrtarë policorë me grada të ndryshme, ndërsa personel civil - pa autorizim policor janë 992.

Në tabelat (nr. 9 dhe 10) në vazhdim pasqyrohen të dhënat lidhur me 208 punonjësit policor të hetuar nga IPK-të ndarë sipas gradave të zyrtarëve që janë hetuar si dhe krahasimi me dy vitet paraqake.

Numri	Kolonel	N/kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Policiri	Shërbyes civil
Numri i punonjësve	33	53	93	169	233	1105	5628	841	992
Numri i të hetuarve nga IPK	1	4	7	4	10	27	147	1	7
Raporti (1:100)	3:100	2:100	8:100	2:100	4:100	2:100	3:100	0:100	1:100

Numri i të hetuarve nga IPK-ja sipas gradave	Kolonel	N/kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Policiri	Shërbyescivi
Viti2018	0	1	1	4	2	12	150	0	24
Viti2019	2	6	5	12	13	57	268	1	13
Viti2020	1	4	7	4	10	27	147	1	7

Policia në bazë të strukturës organizative aktuale përbëhet nga Drejtoria e përgjithshme dhe pesë (5) departamente, ku numrin më të madh të personelit prej 6746 punonjësve e ka Departamenti për Operacione.

Ky Departament përfshin tre divizione (Divizioni për Siguri Publike, Divizionin i Njësive të Specializuara dhe Divizioni për Komunikacion Rrugor), tetë (8) drejtori rajonale policore dhe 41 stacione policore. Bazuar në këtë shpërndarje të personelit policor edhe numri më i madh i zyrtarëve të hetuar nga IPK-ja është pikërisht nga Departamenti për Operacione.


Tabela në vazhdim pasqyron numrin e punonjësve policor të hetuar nga IPK, të ndarë në strukturën organizative policore. Në gjithë departamentet ka ulje të numrit të punonjësve që kanë qenë subjekt hetimi në IPK, me përjashtim të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe DPP- Operativë dhe DPP-Resurse, ku në vitet paraprake nuk ka pasur asnjë punonjës të hetuar nga IPK-ja.

Të gjitha të dhënat e lartcekura janë paraqitur në tabelën nr.11 si në vijim:


	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Drejtoría e Përgjithshme e Policisë	0	0	3
DPP-Operativë	0	0	4
DPP-Resurse	0	0	3
Departamenti për Operacione	142	256	164
Departamenti për Kufi	22	91	25
Departamenti për Shërbime Mbështetëse	20	3	3
Departamenti për Hetime	10	21	6
Departamenti i Burimeve Njerëzore	0	5	0

Bazuar në atë se Departamenti për Operacione përbëhet nga tre (3) divizione, të dhënat e paraqitura në diagram tregojnë pasqyrën e shpërndarjes së 164 punonjësve policor të hetuar në Departamentin për Operacione. Pjesa dërmuese e të hetuarve është shpërndarë në Divizionin për Siguri Publike, ku janë strukturuar drejtoritë rajonale dhe stacionet. Bazuar në të dhënat e IPK-së vërehet një ngritje të numrit të të hetuarve për 21% krahasuar me vitin paraprak ose për 32 punonjës më shumë.


Të dhënat e lartcekura janë paraqitur në diagramin në vijim:



Diagrami në vazhdim jep pasqyrën e shpërndarjes së të hetuarve në tetë (8) Drejtoritëv Rajonale Policore. Gjatë vitit 2020 janë hetuar 152 punonjës policor të angazhuar në këto drejtori. Diagrami pasqyron se DRP - Prishtinë prinë nga të gjitha drejtoritë me numrin më madh të të hetuarve nga radhët e saj duke pasur edhe numrin më të madh të punonjësve të shpërndarë në stacione policore. Ngritje të theksuar të numrit të të hetuarve krahasuar me vitin paraprak ka shënuar DRP – Gjilan dhe DRP Mitrovicë Veri, ndërsa në Drejtoritë tjera ka rënie krahasur me vitin paraprak.



Po ashtu, edhe Policia Kufitare në organizimin e saj strukturor është e përshkallëzuar edhe në nivelin e tri Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare dhe Aeroporti i Prishtinës. Diagrami në vazhdim jep pasqyrën e shpërndarjes së 23 punonjësve të Policisë Kufitare të hetuar nga IPK-ja krahasuar edhe me dy vite paraprake (pa përfshirë edhe dy të hetuar si punonjës të Departamentit të Policisë Kufitare).



Bazuar në fushëveprimin ligjor të IPK-së, sa i përket incidenteve të profilit të lartë dhe shkeljeve disiplinore të nivelit të lartë të menaxhimit dhe atyre të nivelit të lartë ekzekutiv, gjatë vitit 2020, DH-ja ka regjistruar gjashtë (6) raste me karakter disiplinor që lidhen me shkelje disiplinore të profilit të lartë.

7. INSPEKTIMET E STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE POLICORE

Departamenti i Inspektimit është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe funksionon nga viti 2006. Objekt i veprimtarisë së Departamentit është inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës për të siguruar llogaridhënie, efektivitet e efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi⁸.

Duke qenë pjesë integrale e strukturës së organizatës, Departamenti i Inspektimit në përmbushje të mandatit ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme policore, përmes realizimit të inspektimeve (të rregullta dhe të jashtëzakonshme). Inspektimet janë vlerësime të mënyrës së kryerjes së detyrave nga Policia e Kosovës, duke siguruar arritjen e qëllimeve në përputhje me legjislacionin dhe standardet e kërkuara⁹.

Bazuar në Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IPK, përgjegjësitë dhe detyrat e Departamentit të Inspektimit janë: nxjerrja e Planit Vjetor të Inspektimit në fushat e menaxhimit policor të përcaktuar me Ligjin për IPK-në; kryerja e inspektimeve në Polici me iniciativë të vetën ose me urdhër të Ministrit; sigurimi i informatave nga fushat menaxheriale përmes metodave të autorizuara të marrjes dhe sigurimit të tyre; analizimi dhe vlerësimi i kryerjes së detyrave nga struktura policore; hartimi i raporteve të inspektimit të bazuara në standardet e raportimit, duke përfshirë në to gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet¹⁰.

Inspektorët udhëhiqen nga parimet, përfshirë atë të profesionalizmit, objektivitetit, paanshmërisë politike dhe mosdiskriminimit. Inspektorët policor zhvillojnë aktivitetin e tyre në dy divizione: Divizionin për Analizë, Planifikim dhe Cilësi, si dhe në Divizionin e Inspektimit dhe Raportimit. Momentalisht në funksion të IPK-së, Departamenti i Inspektimit ka të angazhuar 13 punonjës me njohuri dhe aftësi të duhura në fushat e kontrollit policor që janë në kompetencë për inspektim.

⁸ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

⁹ Neni 4 i Ligjit të IPK-së (Përkufizimet).

¹⁰ Neni 18 i Rregullores (Departamenti i Inspektimit).

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Përmes aktiviteteve ton ndihmuam në përmirësimin policimit:

- Realizuar shtatë (7) inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme, me analiza të thella dhe përmbajtësore lidhur me të gjitha fushat e menaxhimit;
- Kontrolluar qindra dosje administrative (penale, financiare, prokurimit, etj) dhe realizuar me dhjetëra intervista;
- Rekomanduar avansimin e punës, efikasitetit dhe performancës përmes dhënies së 46 rekomandimeve;
- Verifikuar përmbushjen e rekomandimeve nga fushat e ndryshme të inspektuara më parë.
- Ne punojmë në mënyrë të hapur dhe transparente dhe jemi të përgjegjshëm për atë që bëjmë.

Viti 2020 ishte një vit tjetër produktiv për Departamentin e Inspektimit, me gjithë sfidat evidente që kanë vështirësuar arritjen e objektivave. Sidoqoftë, me gjithë faktin se pandemia Covid-19 ka prekur vendin tonë, dhe se Qeveria ka vendosur një numër masash parandaluese, në rrethana të jashtëzakonshme me mundësi dhe fushëveprim të kufizuar, Departamenti falë angazhimit të inspektorëve ka realizuar katër raporte të rëndësishme të dala nga inspektimet e rregullta dhe tre raporte tjera nga inspektimet e jashtëzakonshme. Raportet kanë rezultuar me 46 rekomandime.

Qëllimi i çdo inspektimi është: që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret dhe parimet e procedurat zbatohen si duhet dhe nëse janë të përshtatshme për të arritur qëllimet; që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e saja; që të jepet opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me fushën e menaxhimit; që të parandalojë shkeljet që mund të kryhen gjatë punës në fushën përkatëse; që të identifikojë mangësitë - dobësitë dhe të rekomandojë masa për funksionimin më të mirë.

Përgjatë periudhës afatmesme kohore 2019-2021 DI është orientuar edhe nga Strategjia e IPK-së dhe Plani i saj i Veprimit, nga i cili burojnë edhe planet vjetore të punës.

Planet bazohen në analiza dhe risqet e identifikuar dhe përmes tyre realizohen inspektime që trajtojnë fusha me interes, fusha këto që mund të prodhojnë efekte negative në zhvillimin e duhur policor.

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta ka paraparë inspektime në këto fusha të menaxhimit:

- (a) Menaxhimi i flotës së automjeteve dhe pajisjeve përcjellëse;
- (b) Menaxhimi i burimeve njerëzore;
- (c) Menaxhimi i armëve të zjarrit, municionit dhe pajisjeve tjera policore;
- (d) Policimi në bashkësi nga stacionet policore të rendit;
- (e) Përdorimi i forcës, raportimi dhe shqyrtimi;
- (f) Menaxhimi i kontratave të ndërtimeve dhe renovimeve.

Përshkak të rrethanave të krijuara si rezultat i pandemisë, dy (2) nga inspektimet e planifikuara janë shtyrë për vitin pasues, meqë ndërkohë janë paraqitur kërkesa nga Ministri për realizimin edhe të tre (3) inspektimeve të jashtëzakonshme:

- (a) Vlerësimi i angazhimeve policore në kuadër të masave parandaluese të autoriteteve përgjegjëse në luftimin e Covid-19;
- (b) Vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave të prokurimit publik në kontraktimin e shërbimeve të sigurimit të automjeteve;
- (c) Vlerësimi i efikasitetit të stacioneve policore kufitare në zbatimin e masave parandaluese kundër Covid-19

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE PËR INSPEKTIMET E REALIZUARA

Inspektimi nr. 01/2020:

Vlerësimi i angazhimeve policore në kuadrin e masave parandaluese të autoriteteve përgjegjëse për luftimin e Covid-19

Arsyet e inicimit:

Bazuar në këtë, më 7 prill 2020, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka kërkuar inicimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar respektimin dhe rregullave nga Policia në zbatimin e masave parandaluese kundër Covid-19 në përputhje me vendimet e autoriteteve përgjegjëse për zonat karantinë. Ky inicim ka ardhur pas kërkesës së Ushtruesit të detyrës së Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike. Ditëve të fundit ishte raportuar nga disa medie mbi vështirësitë në menaxhimin e situatës, krahas obligimeve që ka marrë Policia në zbatimin e masave parandaluese rreth Covid-19. Inspektimi i kësaj fushe paraqet interes për vlerësimin e angazhimeve policore në ndërmarrjen e masave parandaluese. Inspektimi është përqendruar në zonat e karantinës të mbikëqyrura nga stacionet përkatëse policore dhe pikëkalimet kufitare.

Objektivat dhe metodologjia

Objektivat e inspektimit janë: vlerësimi i ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme policore në zbatimin e vendimeve të autoriteteve përgjegjëse për aplikimin e masave parandaluese që lidhen me Covid-19; vlerësimi i ndërmarrjes së masave parandaluese nga radhët policore gjatë kryerjes së detyrave dhe përmbushjes së planeve operative.

Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime-intervista me punonjës përgjegjës të strukturave policore, janë kryer kontrole-inspektime fizike të njërive policore në zonat e karantinuara, janë siguruar dhe marrë urdhrat operativ, planet operative, oraret e ndërrimeve, raportet e mbikëqyrësve, logjet ditore dhe raportet tjera mbi ecurinë e zbatimit të masave.

Gjetjet kryesore:

Në vazhden e reagimit për të ndërmarrë masat e sigurisë në kompetencë të PK-së lidhur me masat parandaluese të autorizuar nga institucionet shëndetësore e qeveritare, DPP ka lëshuar Urdhër Operativ për Gatishmëri dhe Reagim për Corona Virusin Covid-19. Konform Urdhrit Operativ, edhe DRP-të kanë hartuar plane, përmes të cilave kanë planifikuar organizimin e funksionimin e kapaciteteve të tyre policore, bashkëpunimin ndër-institucional me institucionet shëndetësore, komunat, dhe ndërmarrjen masave parandaluese bazuar në vendimet e autoriteteve përgjegjëse.

Gjatë inspektimit është vërejtur se stacionet policore që kanë kontrolluar ndalimin e lëvizjes në zonat e karantinuara kanë pasur kapacitete të mjaftueshme të burimeve njerëzore, ngase sipas nevojave janë mbështetur edhe me njësi shtesë nga drejtoritë tjera policore. Duke vlerësuar situatën e krijuar nga pandemia me Covid-19, stacionet policore kanë aktivizuar kapacitetet njerëzore operative me orar 12 orësh. Stacionet kanë vënë theks në vendosjen e pikave statike për kontroll dhe ndalim të hyrje-daljeve në zonat e karantinuara. Përmes patrullimeve kanë pasur në fokus edhe përcjelljen e

situatës, parandalimit të rasteve dhe monitorimin e zbatimit të vendimeve të Qeverisë dhe institucioneve shëndetësore për kufizimin e lirisë së lëvizjes në zonat e tyre të përgjegjësive.

Për të verifikuar zbatimin e masave të kontrollit dhe ndalimit të hyrje-daljeve në zonat e karantinuara, IPK-ja ka realizuar një numër vizitash në disa zona të përgjegjësisë të stacioneve policore ku brenda tyre janë hapur zonat karantinë. Inspektorët kanë hasur se një numër patrullash nuk kanë arritur të zbatojnë sa duhet masat parandaluese, duke mos reflektuar përkushtim e seriozitet për kryerjen e detyrave në zbatimin e masave dhe vendimeve të organeve. Kjo shtron nevojën që drejtuesit e stacioneve të ngritin masat e kontrollit ndaj patrullave, në mënyrë që të shtohet vigjilenca në kufizimin e qasjes dhe lëvizjes së individëve, duke minimizuar shpërndarjen e virusit te qytetarët. Nuk duhet lënë anash edhe vërejtjet lidhur me disa situata kur udhëzimet për zyrtarët policor në terren janë konsideruar si të pazbërthya sa duhet dhe në këtë drejtim kërkohet nga mbikëqyrësit që me rastin e ndarjes së detyrave, të sigurohen se vartësit i kanë kuptuar qartë.

IPK ka evidentuar dhe disa vështirësi apo pengesa për të siguruar një mbikëqyrje efikase policore në zonat e karantinuara, përshkak se pozita apo vendet ku janë gjetur patrullat policore të vendosura, nuk sigurojnë kontroll të duhur, andaj autoritetet policore duhet të analizojnë situatat e tilla në mënyrë që patrullat të mund të sigurojnë mbikëqyrje efikase të rrugëve, përmes të cilave mund të minimizohet lëvizja e qytetarëve e automjeteve. Janë identifikuar edhe rrugë apo shtigje të pambuluara me prani policore, përmes të cilave mund të kihet qasje në karantina.

Gjatë inspektimit janë identifikuar raste kur zyrtarët policor në kuadër të patrullave policore të angazhuar në zbatimin e masave parandaluese, nuk kanë respektuar masat mbrojtëse, duke rrezikuar të jenë të ekspozuar ndaj rrezikut të infektimit me Covid-19. Në këto raste janë vërejtur neglizhime në përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, përfshirë maskat, dorëzat dhe dezinfektuesit. Inspektorët kanë hasur se stacionet policore ballafaqohen me furnizime të kufizuara të pajisjeve mbrojtëse, çka shumë shpesh punonjësit detyrohen t'i sigurojnë vet ato. Kurse, dezinfektimet e hapësirave dhe automjeteve në shumicën e rasteve nuk janë të rregullta dhe kjo shtron nevojën për ndërmarrjen e veprimeve parandaluese në ngritjen e sigurisë së punonjësve.

Rekomandimet:

Lidhur me këtë inspektim janë dhënë pesë (5) rekomandime, të cilat i atribuohen gjetjeve. Me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 02/2020:

Vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave të prokurimit publik në kontraktimin e shërbimeve të sigurimit të automjeteve

Arsyet e inicimit:

Më 9 janar 2020, Kryeshefi Ekzekutiv ka kërkuar inicimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar respektimin e rregullave dhe procedurave të prokurimit publik në kontraktimin e shërbimeve të sigurimit për automjetet policore. Ky inicim ka ardhur pas kërkesës së Ministrit të Punëve të Brendshme, të datës 08.01.2020, pas shqetësimeve se njësia kërkuese në kuadër të Policisë së Kosovës ka specifikuar kërkesa që interferojnë dhe orientojnë tenderin të një operator ekonomik. Vlerësimi i kësaj fushe paraqet interes për të vlerësuar angazhimet e këtij autoriteti kontraktues në arritjen e kontratave të këtyre shërbimeve, bazuar në respektimin e parimeve të ekonomizimit, mosdiskriminimit dhe transparencës. Inspektimi është fokusuar në Drejtorinë e Prokurimit në kuadër të Departamentit për Shërbime Mbështetëse.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat e inspektimit janë: vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave të prokurimit publik nga autoriteti kontraktues; vlerësimi i respektimit të parimeve të ekonomizimit, efikasitetit, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës.

Gjatë inspektimit: janë zhvilluar takime-intervista me punonjës përgjegjës të strukturës policore; është kryer kontroll - inspektim fizik i dosjes së prokurimit me natyrë të shërbimeve të sigurimit të automjeteve policore; dhe është siguruar dhe marrë Plani i prokurimit dhe dosja e aktivitetit të prokurimit.

Gjetjet kryesore:

Shërbimet e sigurimit të automjeteve policore janë përfshirë në Planifikimin përfundimtar të prokurimit për vitin përkatës. Lidhur me këtë aktivitet është paraqitur kërkesa për shërbimet e tilla nga Njësia e kërkesës, që përmban termat e referencës, specifikimet teknike, paramasën dhe parallogarinë. Fillimisht është kryer vlerësimi formal i nevojave që dëshmohet nga DNVDF. Kontrata është klasifikuar me vlerë të madhe dhe për të është organizuar procedurë e hapur.

Dosja e Tenderit është përgatitur me kohë, në formular përkatës të prokurimit, para publikimit të Njoftimit të Kontratës dhe dokumenti i tillë ka qenë i qasshëm dhe i disponueshëm në platformën elektronike. Dosja e Tenderit nuk ka specifika teknike që mund të favorizojnë apo diskriminojnë konkurrencën. Dosja e Tenderit përmban afate të rregullta kohore, siç parashihen me LPP. Kriteret e përzgjedhjes, sidomos të atyre që kanë të bëjnë me kushtet minimale të kualifikimit duhet kushtuar kujdes më i madh në të ardhmen, në mënyrë që të specifikohen më qartë siç përcaktohet me dispozitat ligjore të LPP-së, RUOPP-së, por edhe interpretimet e KRPP-së. Dosja e Tenderit dhe Njoftimi i Kontratës kanë specifikuar qartë kërkesat mbi sigurinë e tenderit, validitetin dhe sigurinë e ekzekutimit. Publikimi i Njoftimit të Kontratës si mjet për promovim të transparencës është bërë konform rregullave, në kuadër të afateve dhe u ka ofruar informacionin e duhur palëve në proces.

Tenderët janë pranuar përmes platformës elektronike dhe hapja e tyre është realizuar duke shfrytëzuar funksionalitetin e hapjes në sistemin elektronik të prokurimit. Nga procesi i hapjes është gjeneruar Procesverbali i hapjes së tenderëve, i cili më pas është nënshkruar nga personat përgjegjës. Komisionet për ekzaminimin, vlerësimin e krahasimin e tenderëve në të gjitha rastet (vlerësim e rivlerësim) janë themeluar nga autoriteti kompetent dhe kanë filluar dhe përfunduar punën përbrenda afateve. Në të gjitha rastet, deklaratat nën betim janë nënshkruar nga anëtarët e komisioneve duke siguruar se përmbushin kërkesat ligjore. Në përfundim të punës, komisionet përkatëse kanë hartuar raportet e vlerësimit të tenderëve. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit para dhënies së kontratës ka siguruar me kohë nga pala e rekomanduar për dhënie të kontratës, dëshmitë për përmbushje të pranueshmërisë.

AK me kohë ka nxjerrë Njoftimet për Vendimin e AK-së bazuar në rekomandimet e komisioneve. Njoftimeve u janë bashkëngjitur edhe Letrat standarde përkatëse për tenderuesit. Çdo herë kur operatorët ekonomik e pakënaqur kanë ushtruar kërkesa për shqyrtim të vendimeve, AK me kohë ka pezulluar aktivitetet dhe ka adresuar kërkesat e tilla. Edhe në rastet kur pala e pakënaqur me vendimet e AK-së ka parashtuar ankesë pranë OSHP-së, AK-ja ka pezulluar procedurat dhe përfilluar kërkesat e organit në fjalë. IPK çmon angazhimin e AK-së në respektimin e vendimeve të Panelit Shqyrtues për anulimin e Njoftimeve për dhënie të kontratës dhe kthimin e lëndës në rivlerësim, por shtyn menaxhmentin që të marrë parasysh gjetjet dhe konstatimet e këtij Paneli, të pasqyruara në vendimet e nxjerra nga ky Organ. Përfundimet e këtij Paneli duhet marrë parasysh gjatë çdo procesi të rivlerësimit të tenderëve.

Pasi Paneli Shqyrtues ka vërtetuar Vendimin e AK-së, AK ka publikuar Njoftimin për Dhënien e Kontratës, që edhe është publikuar në platformën elektronike. Pasi janë përmbushur kushtet për nënshkrimin e kontratës, autoritetet përgjegjëse, përfshirë këtu Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit, Zyrtarin Kryesor Administrativ, Ministrin dhe Operatorin Ekonomik kanë nënshkruar kontratën. Më pas brenda afateve, AK ka përgatitur dhe publikuar Njoftimin për Nënshkrimin e Kontratës.

Nga kontrolli i dosjes së këtij aktiviteti të prokurimit vërehet se ekziston një regjistër përmbledhës i aktivitetit të prokurimit, i përgatitur në mënyrë të rregullt dhe që përmban materien e nevojshme për të dëshmuar rrjedhën e procesit të prokurimit. Dosja ka gjithë dokumentacionin e nevojshëm, duke filluar nga kërkesa për prokurim, deri tek kontrata e nënshkruar nga palët. AK i ka kushtuar kujdes të duhur mjeteve për promovimin e transparencës, përfshirë këtu njoftimet, publikimet, regjistri përmbledhës i prokurimit, etj.

Rekomandimet:

Lidhur me këtë inspektim është dhënë një (1) rekomandim që i atribuohet gjetjeve. Me strukturën përkatëse policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 03/2020:

Vlerësimi i efikasitetit të stacioneve policore kufitare në zbatimin e masave parandaluese kundër Covid-19

Arsyet e inicimit:

Më 3 qershor 2020, Ushtruesi i detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së ka kërkuar inicimin e një inspektimi të jashtëzakonshëm për të vlerësuar kryerjen e detyrave policore nga stacionet kufitare në Vërmicë dhe në Qafë Prush gjatë zbatimit të masave kundër Covid-19. Ky inicim ka ardhur pas kërkesës të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Administratës Publike, që të konstatohet respektimi i masave sipas vendimeve qeveritare dhe urdhrave policore gjatë kohës së pandemisë, përfshirë evidentimin e hyrje - daljeve brenda dhe jashtë vendit. Inspektimi i kësaj fushe paraqet interes për vlerësimin e angazhimeve policore në ndërmarrjen e masave të nevojshme. Inspektimi është fokusuar në SPK-të në Vërmicë dhe Qafë Prush.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat e inspektimit janë: vlerësimi i angazhimit të kapaciteteve të nevojshme të burimeve njerëzore policore në ndërmarrjen e masave parandaluese; vlerësimi i masave parandaluese të ndërmarra gjatë pandemisë nga SPK-të, përfshirë dhe evidentimin e të gjitha hyrje daljeve brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë inspektimit: janë zhvilluar takime-intervista me punonjës përgjegjës të strukturave policore kufitare; janë siguruar e marrë urdhrat - planet, oraret e ndërrimeve, raportet e mbikëqyrësve lidhur me ecurinë e zbatimit të masave, evidencat fizike të të gjitha hyrje - daljeve kufitare; si dhe janë siguruar video regjistrime të monitorimit.

Gjetjet kryesore:

Në drejtim të ashpërsimit të masave për parandalimin e përhapjes së virusit Covid - 19, Qeveria ka vendosur mbylljen e kufijve tokësor për udhëtarët që hyjnë në Kosovë. Në vazhden e reagimit për të ndërmarrë masat e sigurisë në kompetencë të PK-së lidhur me masat parandaluese të autorizuara nga institucionet shëndetësore e qeveritare, DPP-ja ka lëshuar Urdhër Operativ për Gatishmëri dhe Reagim për Corona Virusin Covid-19. Me qëllim të vlerësimin të zbatimit të këtyre masave, IPK ka kryer inspektime dhe vizita në SPK në Vërmicë dhe Qafë Prush. Konform Urdhrit në fjalë, vërehet se këto stacione kanë planifikuar organizimin mbi funksionimin e kapaciteteve të burimeve të tyre policore, me orar 12 orësh (në kuadër të orareve është përfshirë i tërë personeli policor në përjashtim të zyrtarëve policor që vuajnë nga sëmundje kronike, siç rekomandojnë institucionet shëndetësore).

Udhëheqësit e SPK-ve në saje të angazhimeve të tyre edhe gjatë muajit maj, i cili ka qenë fokus i këtij inspektimi, kanë pasur bashkëpunim të ngushtë me akterët tjerë institucional të angazhuar në zbatimin e masave parandaluese kundër Covid-19 (Doganat e Kosovës dhe institucionet shëndetësore). SPK në Vërmicë kishte ndarë hapësirë të veçantë për vendosjen e personave, për të cilët ka pasur dyshime se mund të jenë të prekur nga Covid-19, ndërsa në SPK-Qafë Prush nuk kishte pasur hapësirë

të ndarë për shërbime të kësaj natyre. Sipas video inçizimeve të siguruara nga QKMK është vërejtur se një numër i ngasësve të maunave që kanë kaluar kufirin nuk kanë bartur maska mbrojtëse dhe dorëza (nuk është vërejtur ndonjë veprim i njërive policore që t'i pajisin personat e tillë me pajisje siç parashihet me Udhëzuesin nr. 107/2020 për aplikim të masave shtesë për maunat apo të mjeteve tjera transportuese të mallrave që hyjnë në Kosovë me shofer shtetas të huaj.

Bazuar në raportet policore të muajit maj të këtij viti, në pikëkalimet kufitare në Vërmicë dhe Qafë Prush ka pasur lëvizje të reduktuar të personave dhe automjeteve, krahasuar me periudhen e njëjtë të vitit paraprak. Për parandalimin e përhapjes së virusit dhe mbrojtje të shëndetit publik është e rëndësishme që masa e aplikimit të kontrolleve shëndetësore të aplikohet ndaj secilit që hyn në Kosovë. Evidencat pasqyrojnë se gjatë muajit maj, rreth $\frac{3}{4}$ e personave që kanë hyrë në Kosovë përmes Vërmicës u janë nënshtruar kontrolleve shëndetësore. Për numrin e kontrolleve të tilla për personat që kanë hyrë në Kosovë përmes Qafë Prushit, nuk është arritur të bëhet një pasqyrim i saktë për shkak të mungesës së evidencave të qarta të ofruara nga stacioni.

Evidencat nga baza e të dhënave (SMK) për muajin maj tregojnë se përmes Pikës së Kalimit Kufitar në Vërmicë kanë hyrë një numër i konsideruar i shtetasve të huaj, hyrja e të cilëve është aprovuar nga autoritetet përkatëse. Me qëllim të verifikimit të kryerjes së kontrolleve dhe regjistrimin e personave dhe automjeteve në dy pikë kalimet kufitare, inspektorët e IPK-së kanë identifikuar një numër të konsiderueshëm të automjeteve që gjatë hyrjes në Kosovë nuk janë regjistruar në Sistem nga zyrtarët policor kufitar.

Rekomandimet:

Lidhur me këtë inspektim është dhënë një (1) rekomandim, që i atribuohet gjetjeve. Me strukturën përkatëse policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 04/2020:

Menaxhimi i armëve të zjarrit, municionit dhe pajisjeve tjera policore

Arsyet e inicimit:

Plani Vjetor ka paraparë këtë inspektim dhe paraqet një fushë me interes që të vlerësohet nëse struktura policore ka kapacitete të mjaftueshme teknike e njerëzore për të kryer detyrat në raport me përgjegjësitë e përcaktuara. Është me rëndësi të konstatohet se menaxhimi i armëve të zjarrit, municionit dhe pajisjeve policore ndikon në përmbushjen me sukses të objektivave të përcaktuara nga Policia. Duke konsideruar se inspektimi paraqet instrument të suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 5 shkurt 2020, mbi bazën e Programit të punës inspektuese, ka iniciuar një inspektim për vlerësuar performancën policore në këtë fushë të menaxhimit. Inicimi i inspektimit është ndikuar dhe nga nevoja që Policia të sigurohet se këto pasuri janë të kontrolluara, të përdorura dhe ruajtura në mënyrën e duhur. IPK është interesuar të rishikoj edhe nivelin e përmbushjes së rekomandimeve nga inspektimi i kaluar të realizuar në këtë fushë, të pasqyruara në Raportin e inspektimit nr. 03/2018, të datës 14.08.2018. Inspektimi është përqendruar në Drejtorinë e Logjistikës, NJAM, DNJS, DRP dhe DRPK.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat e inspektimit janë: vlerësimi i nivelit të pajisjes së zyrtarëve policorë me armë, municion dhe pajisje tjera; vlerësimi i afateve të përdorimit të municionit dhe pajisjeve; vlerësimi i kushteve e masave të sigurisë në ruajtjen dhe përdorimin e armëve të zjarrit, përfshirë dhe poligonin e qitjes; vlerësimi i evidencave mbi armët, municionin dhe pajisjet tjera; vlerësimi i përmbushjes së detyrimeve për përfshirjen e zyrtarëve policor në programin e ricertifikimit; vlerësimi i përmbushjes së rekomandimeve të kaluara.

Gjatë inspektimit: janë zhvilluar takime - intervista me drejtues, punonjës dhe bartës funksionesh, janë kryer inspektime të: Depos së NJAM-së dhe Logjistikës, armëtoreve të njërive, mirëmbajtjes së armëve, kushteve për akomodim dhe ruajtje të armëve e municionit, gjendjes teknike dhe sigurisë së poligoneve të qitjes; janë plotësuar formularët e inspektimit për verifikim të kushteve fizike e të sigurisë në armëtore/depo/poligone dhe vlerësimin e pajisjes me armë dhe municion; janë marrë dokumente të shkruara (raporte vjetore të punës, dëshmi mbi trajnimet dhe kapacitetet, dëshmi mbi inspektimin e armëve, municionit e pajisjeve policore nga menaxherët, dëshmi mbi kushtet teknike dhe të sigurisë, si dhe dëshmi tjera mbi fushën).

Gjetjet kryesore:

Policia si shërbim publik me autorizime të veçanta për përdorimin e forcës, ka në disponim një infrastrukturë të gjërë aktesh ligjore e nënligjore, që rregullojnë të drejtën e mbajtjes së armëve, municioneve dhe pajisjeve, llojet, përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Disa PSO që lidhen me fushën duhet nxjerrë, gjersa disa të tjera kanë nevojë të freskohen. Policia për nevojat e saj ka në përdorim armë, municion dhe pajisje tjera

operative konform Listës së Autorizuar të PQV-ve¹¹. Struktura përgjegjëse mbanë evidenca mbi armët, municionin dhe pajisjet, por mbajtja e një baze të avancuar të të dhënash mbetet prioritet. Përshkak të lëvizjes së armëve, ka raste kur Regjistri i armëve nuk ka të dhëna të përditësuara dhe kjo është rezultat i mosbashkëpunimit të njësisve me Njësinë e Armëve dhe Municionit (NJAM). Shkalla e realizimit të projekteve që lidhen me armë, municion dhe pajisje nuk është e kënaqshme në dy vitet e fundit dhe kjo bën që të ngecin një numër projektesh.

Inspektimi vë në pah gjendje të qëndrueshme të stoqeve me armë dhe municion, ka ndodhur zëvendësimi i municionit dhe sprejit OC, por është identifikuar edhe numër i madh i jelekëve anti - plumb me afat të skaduar të përdorimit. Ende nuk është përmbyllur procesi i kthimit të armëve të shkurtra, që më herët iu janë dhënë disa institucioneve dhe bartësve të funksioneve shtetërore. Mbi përdorimin e armëve të përbashkëta në Polici mbahen evidenca të pranimit - dorëzimit. Është e nevojshme që të punohet edhe më tej në sigurimin e vendeve të sigurta për mbushje, zbrazje dhe pastrimin e armëve. Ka lëvizje pozitive në drejtim të shtimit të numrit të inspektimeve lidhur me armët, municionin e pajisjet, por këto duhet të dëshmojnë edhe nga vetë Drejtoria e Logjistikës. Lidhur me atë se si ruhen armët dhe municioni në situata kur zyrtarët policor nuk janë në detyrë, apo i dorëzojnë ato për ruajtje në kuadër të shërbimit, vlerësohet e nevojshme ngritja e masave të sigurisë në ruajtjen e armëve dhe municionit, duke i kushtuar kujdes të duhur lokacionit, paketimit, kufizimit të qasjes dhe bartjes së përgjegjësive mbikëqyrëse. Inspektimi i mëse 50 zyrtarëve policor ka dëshmuar se ata janë hasur duke bartur komplet pajisjet, ku hyjnë rripi i uniformës dhe pajisjet që barten në rrip, armët e tyre janë hasur të pastra dhe me municion zyrtar. NJRSH-të në kuadër të DRP-ve dhe NJSO-të dhe NJSIkanë mungesa në disa prej llojeve të pajisjeve dhe pajisje të pamjaftueshme.

Nevojitet një analizë më e thellë menaxheriale për të vlerësuar përmbushjen e standardeve themelore të kushteve të ruajtjes së armëve dhe municionit (armëtoreve). Depo e NJAM-it është më e avansuar krahasuar me armëtoret e njësisve tjera policore. PSO - të e disa prej njësisve policore duhet të rifreskohen duke marrë për bazë legjislacionin sekondar që rregullon kushtet minimale të ruajtjes dhe të sigurisë së armëve e municionit. Lidhur me furnizimin, shpërndarjen dhe transportin e armëve nuk janë hasur dobësi, ngase Policia ka të rregulluar një procedurë të qartë mbi funksione të tilla. Policia ka personel të certifikuar për riparim dhe servisim të armëve, në përjashtim të disa llojeve të armëve të gjata, për të cilat ndihet nevoja e përgatitjes së kuadrove adekuate. NJAM ka pasqyruar raporte mbi evidencat e historikut të mirëmbajtjes së armëve, lidhur me riparimin, pastrimin, lubrifikimin dhe vlerësimin e nivelit të korodimit.

Policia ka në funksion poligone të qitjes për nevoja të trajnimit të zyrtarëve policor në përdorimin e armëve të zjarrit, të cilat ende nuk janë certifikuar nga organi kompetent

¹¹ Sipas Ligjit nr. 03/L-246 për pajisjeme armë, municion, pajisjet e sigurisë për institucionet autorizuara shtetërore për siguri (i ndryshuar - plotësuar me Ligjin nr. 05/L-017) termi "Pajisje për qëllime të veçanta" përfshinë armët, municionin dhe pajisjet përkatëse për siguri të dedikuara për institucionet shtetërore për siguri.


dhe kjo shtron nevojën që të punohet në këtë drejtim. Sa i përket kushteve teknike dhe të sigurisë së poligoneve të qitjes, vetëm Poligoni i mbyllur në Prishtinë në kuadër të DPP-së ka përmbushur pjesën dërrmuese të kritereve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, kurse poligonet e hapura të shpërndara në disa DRP ballafaqohen me shumë probleme teknike dhe të sigurisë sa i përket kushteve të parapara. IPK nuk ka hasur që struktura përgjegjëse të ketë nxjerrë Udhëzuesin e procedurave standarde të operimit, i cili përcakton kërkesat për personat që i qasen poligoneve të qitjes.

Divizioni i Trajnimeve synon të siguroj që policët janë të trajnuar në përdorimin dhe mirëmbajtjen e armëve, por një numri të trajnerëve e instruktorëve të tij iu ka skaduar afati ligjor i certifikatave. Inspektorët janë të njohur se është në proces ricertifikimi për instruktorët dhe po punohet në nxjerrjen e dokumentit, që do të rregulloj mënyrën e ricertifikimit të instruktorëve në të ardhmen. Dhe kësaj radhe inspektorët nuk janë ndarë të kënaqur me trendin e vijueshmërisë së zyrtarëve policor në kursin e ricertifikimit për armët e zjarrit për këto dy vitet e fundit. Evidencat mbi ndjekjen e këtij kursi duhen të detajizohen në të ardhmen, për të pasqyruar më mirë numrin e planifikuar dhe numrin e ndjekësve të kursit të ricertifikimit për dy kategoritë: ricertifikimi për përdorimin e armëve të zjarrit Glock dhe për kategorinë e njësive të specializuara dhe njësive tjera, për të cilat parashihen paketë e veçanta të kurseve për ricertifikim edhe për përdorim të armëve të gjata. Ndihet e nevojshme që për disa njësi policore, të cilat përdorin armë të gjata, siç është rasti me policinë kufitare dhe njësitë e reagimit të shpejt, të shqyrtohet mundësia e krijimit të pakove të veçanta të trajnimit të ricertifikimit, siç parashihet për njësitë tjera të specializuara (NJSI, NJSO, NJMA, etj).

Rekomandimet:

Lidhur me inspektimin janë dhënë 13 rekomandime, të cilat i atribuohen gjetjeve. Me strukturën përkatëse policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Ky inspektim ka verifikuar po ashtu dhe përmbushjen e rekomandimeve të inspektimit të kaluar dhe ka rezultuar se nga 14 rekomandime të lëna herën e fundit (inspektimi nr . 03/2018), pesë (5) prej tyre janë përmbushur plotësisht, dy (2) janë përmbushur përgjithësisht (në masë të madhe), tre (3) janë përmbushur pjesërisht, dy (2) nuk janë përmbushur fare dhe dy (2) rekomandime nuk janë vlerësuar.



Inspektimi nr. 05/2020: Përdorimi i forcës, raportimi dhe shqyrtimi

Arsyet e inicimit:

Plani Vjetor i Inspektimit ka paraparë këtë inspektim dhe paraqet një fushë me interes me qëllim që të vlerësohet nëse Policia është e përgatitur profesionalisht të përdorë forcë proporcionale, të arsyeshme dhe të nevojshme në situata kur është i pashmangshëm reagimi policor. IPK shpesh trajton ankesa të qytetarëve, të cilat përmbajnë materie mbi përdorimin e forcës. Është me rëndësi të dihet nëse forca e përdorur raportohet dhe shqyrtohet nga autoriteti përgjegjës. Inicimi i këtij inspektimi është ndikuar dhe nga nevoja që të kuptohet nëse Policia zbaton strategji apo politika të mbledhjes së të dhënave të nevojshme mbi përdorimin e forcës fizike, armëve dhe pajisjeve policore. Mirëmbajtja e të dhënave të integruara mbi rastet dhe incidentet me përdorim force mundësojnë pasqyrimin e profesionalizmit policor për reagim, kushtet e sigurisë në shoqëri dhe trendet për të krijuar ambient më të qetë. Duke konsideruar se inspektimi paraqet një instrument të suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 19 shkurt 2020, mbi bazën e Programit të punës inspektuese, ka iniciuar një inspektim për të vlerësuar performancën policore në këtë fushë. Inspektimi është fokusuar në DSP, KSHPF, NJSO, NJRSH, Divizionin e Trajnimeve, Sektorët Rajonal të Resurseve dhe Sektorët e Resurseve në Stacione.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat e inspektimit janë: vlerësimi i procesit të mbledhjes së të dhënave mbi raportimin e përdorimit të forcës; verifikimi i raportimit të përdorimit të forcës lidhur me ankesat e ushtruara nga palët; vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave të raportimit të përdorimit të forcës dhe trajtimi i tyre nga KSHPF; vlerësimi i trajtimit të rasteve të përdorimit të forcës, pas shqyrtimit nga Komisioni; vlerësimi i kurrikulës dhe programit trajnues për përdorimin e forcës.

Gjatë inspektimit: janë zhvilluar takime - intervista me drejtues, punonjës dhe bartës funksionesh; janë kryer: verifikime të rasteve të hetuara nga IPK dhe të proceduara në Prokurori, nëse për të njëjtat është raportuar përdorimi i forcës në stacione e njësi policore, verifikime të rasteve të trajtuara nga DHBVK, nëse për të njëjtat është raportuar përdorimi i forcës në stacione dhe njësi policore, kontrole të raporteve të policëve dhe raporteve 24 orëshe të incidenteve të muajve të fundit në njësi dhe stacione policore, nëse kanë përmbajtje që dëshmojnë përdorim të paraportuar të forcës, kontrole të dosjeve në KSHPF, për të vlerësuar respektimin e rregullave/procedurave të shqyrtimit të rasteve; është plotësuar formulari i inspektimit për të verifikuar respektimin e rregullave dhe procedurave për raportimin, procedimin dhe shqyrtimin e rasteve nga Komisioni përkatës; janë siguruar e marrë dokumente të shkruara si në vijim në interes të inspektimit.

Gjetjet kryesore:

Ligji nr. 04/L-076 për Policinë përcakton dhe rregullon përdorimin e forcës dhe armës së zjarrit nga zyrtarët policor. Sipas Ligjit, zyrtarët policor janë të autorizuar të përdorin forcë, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për t'i arritur objektivat legjitime policore. Legjislacioni që trajton fushën

e përdorimit të forcës përfshinë edhe Udhëzimin Administrativ nr. 02/2012 për përdorimin e forcës nga zyrtarët policor, si dhe Udhëzimin Administrativ nr. 03/2012 për përdorimin e armëve të zjarrit nga zyrtarët policor. Në funksion të raportimit dhe shqyrtimit të përdorimit të forcës, Policia ka në zbatim Procedurën Standarde të Operimit për Komisionin e Shqyrtimit të Përdorimit të Forcës. Policia ka infrastrukturë ligjore të mbështetur nga prova më të mira në dispozicion që mbulon fushat me interes mbi përdorimin dhe raportimin e forcës.

Lidhur me administrimin e të dhënave mbi incidentet e përdorimit të forcës, në shumicën prej stacioneve dhe sektorëve rajonal për resurse mbahen evidenca në word e excel mbi incidentet me informata të thjeshtëzuara bazuar në rastet e raportuara. Lidhur me rastet e raportuar në KSHPF dhe trajtimin e tyre, mbahen evidenca nga personeli, që administrojnë me databazën e të dhënave mbi rastet. Nuk është hasur në praktika të evidentimit të rasteve të përdorimit të forcës në ndonjë program softverik në formë të regjistrit të integruar, që gjeneron raporte mbi trendet e përdorimit të forcës me indikatorë me rëndësi. Praktika e tillë do të ishte e dobishme për organizatën, ngritë transparencën, vë në pah integritetin policor dhe vetëdijeson stafin se kjo fushë po monitorohet.

Sipas legjislacionit, zyrtari policor që përdorë forcë fizike menjëherë pas incidentit obligohet të raportojë përdorimin e forcës në formularin e përdorimit të forcës. Inspektimi vë në pah se jo në të gjitha rastet e përdorimit të forcës, ajo raportohet përmes formularit përkatës. Një numër i konsideruar i lëndëve të trajtuar nga IPK brenda përgjegjësive për hetim penal dhe nga DHBVK nuk kanë pasur të raportuar përdorimin e forcës përmes formularit përkatës të raportimit siç e parasheh legjislacioni. KSHPF brenda vitit 2019 ka shqyrtuar 91% të lëndëve në kompetencë të saj. Verifikimi i raporteve 24 orëshe dhe raporteve policore vë në pah se raportimi i përdorimit të forcës në rastet e vendosjes së prangave është sfidë dhe kërkon trajtim serioz nga struktura policore.

KSHPF konsiderohet se është autoriteti i përgatitur për shqyrtimin e lëndëve dhe se trajtimi i tyre mbetet me prioritet. KSHPF në një numër minimal lëndësh që arrinë në kuotën prej 0.5% të lëndëve të trajtuara gjatë vitit 2019 nuk ka arsyetuar përdorimin e forcës nga zyrtarët policor. Nga gjithsej 552 lëndë të shqyrtuara nga KSHPF për vitin 2019, IPK ka kontrolluar 10% të tyre dhe ka rezultuar se në 23% të lëndëve të përzgjedhura për inspektim nuk janë respektuar në plotni rregullat e procedurat e shqyrtimit të përdorimit të forcës, ngase është vërejtur mungesë e procesverbaleve, tejkalim i afateve të shqyrtimit të rasteve dhe mosrespektim të kriterit etnik apo gjinor lidhur me përbërjen e paneleve. Në të gjitha rastet kur KSHPF nuk ka arsyetuar përdorimin e forcës nga zyrtarët policor, ka rekomanduar trajnime shtesë në fushën e përdorimit të forcës. Policia ka programe të ndara trajnuese në fushën e përdorimit të forcës dhe temat brenda tyre japin njohuri të mjaftueshme për fushën e përdorimit të forcës fizike apo armës së zjarrit. Veç tyre janë në funksion dhe programet e ricertifikimit, që po ashtu ofrojnë njohuritë e domosdoshme për përdorimin e forcës për zyrtarët policor që përfshihen në procese të tilla.

Rekomandimet:

Lidhur me këtë inspektim janë dhënë tre (3) rekomandime, të cilat i atribuohen gjetjeve. Me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 06/2020: Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Kosovës

Arsyet e inicimit:

Plani Vjetor i Inspektimit ka paraparë këtë inspektim dhe paraqet fushë me interes për IPK-në me qëllim të vlerësimit nëse Policia ka ndërtuar strukturë organizative funksionale dhe ka kapacitete të mjaftueshme policore për të kryer detyrat në raport me përgjegjësitë. Është me rëndësi të konstatohet se menaxhimi i burimeve njerëzore ndikon në përmbushjen me sukses të objektivave të përcaktuara nga Policia. Duke konsideruar se inspektimi paraqet një instrument të suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 26 shkurt 2020, mbi bazën e Programit të punës inspektuese, ka iniciuar inspektim për të vlerësuar performancën policore në këtë fushë të menaxhimit. Inicimi i inspektimit është ndikuar edhe nga nevoja që PK të sigurohet se burimet njerëzore janë të shpërndara duke respektuar parimet e objektivitetit, profesionalizmit dhe meritokracisë. IPK është e interesuar të rishikoj dhe nivelin e përmbushjes së rekomandimeve nga inspektimi i kaluar, të realizuar në këtë fushë, të pasqyruara në Raportin e inspektimit nr. 04/2018, të datës 11.10.2018. Inspektimi është fokusuar në të gjitha departamentet, divizionet, drejtoritë, sektorët dhe njësitë policore të Policisë.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat e inspektimit janë: vlerësimi i procesit të reformës organizative policore; vlerësimi i kapaciteteve, sistemimit e lëvizjes të personelit; vlerësimi i politikës së gradimit dhe respektimit të rregullave dhe procedurave të ngritjes në karrierë; vlerësimi i administrimit të dosjeve të punonjësve; si dhe vlerësimi i përmbushjes së rekomandimeve të inspektimeve të kaluara.

Gjatë inspektimit: janë zhvilluar intervista-takime me punonjës e bartës të funksioneve; janë kryer inspektime-kontrolle të: shpërndarjes/sistemimit/lëvizjes së personelit dhe dosjeve të personelit; janë plotësuar formularët e inspektimit për të vlerësuar kapacitetet e burimeve njerëzore të angazhuara; janë marrë dokumente të shkruara në interes të inspektimit.

Gjetjet kryesore:

Policia ka një numër të madh punonjësish të uniformuar dhe shërbyesish civil, që paraqesin një nga faktorët e rëndësishëm për përmbushjen e mandatit ligjor, për të siguruar rend dhe ligj, me një ambient të sigurtë për qytetarët e vendit. Përshkak të specifikave të ndryshme dhe dinamikës së zhvillimeve brenda e jashtë saj, Policia vazhdon t'i ekspozohet ndryshimeve të vazhdueshme strukturore e organizative. Policia ka filluar një proces të rishikimit funksional, por që praktikisht ka ngecur. Rregullorja në fuqi për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, në kuadër të saj përmban Strukturën organizative që bie ndesh me vetë përmbajtjen e Rregullores. Kjo Strukturë ka filluar të funksionalizohet e ndarë nga Rregullorja ekzistuese, kurse Policia synon që një proces i inicuar për nxjerrjen e Rregullores së re të përmyllet së shpejti. IPK vlerëson se nxjerrja e një Rregulloreje lidhet edhe me afatet që rrjedhin nga dokumentet qeveritare për të hartimin e tyre, në vazhden e reformave organizative të administratës publike. Andaj, Policia në procesin

e rishikimit funksional duhet të fokusohet në ndarjen e duhur strukturore e funksionale, shpërndarjen e duhur të burimeve, aplikimin e standardeve të njëjta për ndarjet strukturore, kriteret bazike të kontrollit lidhur me numrin e vartësve, etj.

Sa i përket diversitetit etnik dhe gjinor, IPK vlerëson se Policia ka demonstruar se respekton të drejtat e komuniteteve etnike dhe atyre gjinore që të përfaqësohen në kuadrin e saj. Inspektimi vë në pah se kemi një ngritje të moshës mesatare, duke synuar përmirësimin e gjendjes me aprovimin e legjislacionit për pensionimin e parakohshëm të zyrtarëve policor. Krahasuar me tre vite më parë, gjendja me kapacitete të burimeve njerëzore vlerësohet jo e kënaqshme, por me gjasa të sanimit gradual të gjendjes ekzistuese, duke pritur dhe rekrutimin e gjeneratave të reja të kadetëve. Mungesë e të graduarve është evidentuar pothuajse në shumicën e niveleve, por me theks të veçantë vërehet mungesë më e theksuar e personelit të uniformuar në gradat rreshter dhe toger. Është evidentuar mungesë e 300 të graduarve për të plotësuar pozitat që parashihen me Strukturën organizative.


Policia vazhdon të ketë ende probleme me sistemimin e personelit dhe kësaj radhe janë hasur shumë raste të shpërputhjes gradë - pozitë. Vërehen situata kur punonjës me grada ushtrojnë detyra në pozita më të larta se që parashihet për gradat përkatëse, si dhe anasjelltas. Po ashtu, është identifikuar një numër i konsideruar punonjësish policor që vazhdojnë të angazhohen në detyra të ndryshme edhe pse nuk janë të sistemuar si rezultat i ristrukturimit organizativ. Me gjithë numrin në rënie krahasuar me vitet paraprake, edhe gjatë këtij inspektimi janë evidentuar raste të tejkalimit të afateve ligjore për të angazhuarit si ushtrues të detyrës. Inspektimi vë në pah se janë respektuar procedurat e kriteret e rikthimit në Polici për punonjësit, që për arsye të caktuara kanë pezulluar marrëdhënien e punës. Konkursët e brendshme për plotësim të vendeve të lira të punës vazhdojnë të aplikohen shumë pak dhe në këtë drejtim organizata duhet të ofroj mundësi më të mëdha për të rritur konkurrencën. Nga kontrolli i disa prej dosjeve të konkurseve të brendshme, vërehet se në masë të madhe respektohen rregullat dhe procedurat në fuqi, por me disa lëshime të identifikuar. Procesi i gradimit për kolonel ka përmbajtur disa lëshime që mund të prekin integritetin e tij dhe kjo shtron nevojën që në të ardhmen të eliminohen lëshimet e tilla, me një rol aktiv në proces, të Njësisë për Zhvillim në Karrierë dhe Performancë.

Dhoma e dosjeve ka qenë fokus i inspektimit dhe inspektorët mbi bazën e kontrollit të një numri të konsideruar të dosjeve personale aktive dhe pasive të punonjësve, kanë vlerësuar se ato nuk janë të përditësuara sa duhet me gjithë informacionin e nevojshëm. Ka nevojë për respektimin më strikt të rregullave e procedurave mbi pranimin e dosjeve përmes vijave zyrtare të komunikimit. Ka ngecie në respektimin e afateve kohore për largimin e dosjeve pasive nga Dhoma e dosjeve. Gjetjet e inspektimit pasqyrojnë se dosja elektronike e personelit nuk mbahet dhe në mungesë të saj edhe nuk ruhet jashtë objektit siç parashihet me rregull. Nuk ka ende praktika të inspektimeve vjetore të realizuara nga komisionet përkatëse, të cilat duhet krijuar nga menaxhmenti, përmes të cilave do të rishikohej procedura e punës mbi pranimin e dokumenteve, mbajtjen e regjistrave, sistemimin në kuadër të dosjeve, rregullësinë e dosjeve dhe kushtet fizike dhe të sigurisë.

Rekomandimet:

Lidhur me këtë inspektim janë dhënë dhjetë (10) rekomandime, të cilat i atribuohen gjetjeve. Me strukturën përkatëse policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Ky inspektim ka verifikuar po ashtu dhe përmbushjen e rekomandimeve të inspektimit të kaluar dhe ka rezultuar se nga shtatë (7) rekomandime të lëna herën e fundit (inspektimi nr. 4/2018), një (1) prej tyre është përmbushur plotësisht, dy (2) janë përmbushur përgjithësisht (në masë të madhe), një (1) është përmbushur pjesërisht, dy (2) nuk janë përmbushur dhe dy (2) të tjera nuk janë vlerësuar nga IPK-ja.



Inspektimi nr. 07/2020: Menaxhimi i flotës së automjeteve dhe pajisjeve policore

Arsyet e inicimit:

Plani Vjetor i Inspektimit ka paraparë këtë inspektim dhe paraqet një fushë me interes për IPK-në, me qëllim që të vlerësojë nëse Policia ka kapacitete të mjaftueshme teknike dhe njerëzore për të kryer detyrat në raport me përgjegjësitë e përcaktuara. Është me rëndësi të konstatohet se menaxhimi i flotës së automjeteve dhe pajisjeve tjera policore po ndikon në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna nga Policia. Kjo fushë bartë risk për menaxhimentin përshkak të përdorimit të automjeteve, të përcjellur me një kosto të lartë dhe paraqet një nga investimet më të kushtueshme të organizatës policore. Duke konsideruar se inspektimi paraqet një instrument të suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 3 shkurt 2020, mbi bazën e Programit të punës inspektuese, ka iniciuar këtë inspektim për vlerësuar performancën policore në këtë fushë të menaxhimit. Inicimi i inspektimit është ndikuar edhe nga nevoja që Policia të sigurohet se këto asete janë të kontrolluara, të përdorura dhe të ruajtura në mënyrën e duhur. IPK është interesuar të rishikojë edhe nivelin e përmbushjes së rekomandimeve nga inspektimi i kaluar, të realizuar në këtë fushë, të pasqyruara në Raportin e inspektimit nr. 01/2017, të datës 25.09.2017. Inspektimi është përqendruar në Flotën Operative në kuadër të Drejtorisë së Logjistikës, si dhe në sektorët e administratës së stacioneve policore.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat e inspektimit janë: të analizohet e përcaktohet gjendja teknike e automjeteve policore, përfshirë koston e tyre përgjatë ciklit jetësor të tyre; të analizohet dhe vlerësohet respektimi i procedurave gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe servisimit të automjeteve; të analizohen dhe nxirren treguesit e efikasitetit të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe të servisimit të automjeteve; të vlerësohet respektimi i procedurave dhe afateve kohore lidhur me regjistrimin dhe sigurimin e automjeteve; të vlerësohet niveli i pajimit të automjeteve policore me pajisjet e nevojshme, si dhe kujdesi ndaj tyre; të verifikohet disponueshmëria e pjesëve dhe përputhshmëria e gjendjes së stokut me evidencat në Depon e Flotës Operative; të vlerësohet përmbushja e rekomandimeve të dhëna nga inspektimet e kaluara.

Gjatë inspektimit: janë zhvilluar takime-intervista me 21 drejtues, punonjës e bartës funksionesh; janë kryer inspektime - kontrole të: procesit të mirëmbajtjes së automjeteve në kuadër të Flotës Operative, gjendjes teknike dhe përkujdesjes ndaj automjeteve policore, dosjeve të aksidenteve, evidencave të stoqeve të pjesëve rezervë dhe lejeve të qarkullimit të automjeteve policore; janë plotësuar formularët e inspektimit për të vlerësuar pajisjen e automjeteve policore me pajisjet dhe dokumentet e nevojshme, respektimin e procedurave të mirëmbajtjes së automjeteve policore nga personeli i Flotës, mbajtjen e dosjeve të aksidenteve, respektimin e afateve mbi regjistrimin e automjeteve; janë marrë dokumente të shkruara në interes të inspektimit.

Gjetjet kryesore:

Automjetet janë aset shumë i rëndësishëm për Policinë dhe varësisht nga gjendja dhe

mirëmbajtja e tyre, varet edhe efikasiteti dhe performanca e njësive policore në përmbushje të mandatit ligjor. Sipas matjeve dhe vlerësimeve të bëra nga IPK, Policia vazhdon të ketë një park automjesh të vjetëruar dhe krahasuar me matjet e para tre viteve, ka vazhduar të shtyhet edhe më tutje mosha e saj. Inspektimi i kryer në 16 stacione ka dëshmuar se gjendja teknike e automjeteve vazhdon të jetë jo e kënaqshme. Plani i zëvendësimit të automjeteve që ka për qëllim përmirësimin e gjendjes me automjete, këto tre vite nuk ka ndjekur ritmin e nevojshëm dhe shihet se furnizimet e planifikuara nuk realizohen për shkak të ndikimit të disa faktorëve. Janë për t'u çmuar nismat e realizuara për tjetërsimin e automjeteve, në drejtim të freskimit të Parkut, por edhe shmangies së krijimit të shpenzimeve të panevojshme në revitalizimin e tyre. Parku është liruar nga një pjesë e madhe e automjeteve, që janë hequr nga Regjistri i Pasurive.

Inspektorët kanë vërejtur se ka angazhime dhe aktivitete në stacione për të mbikëqyrur dhe kontrolluar gjendjen e automjeteve dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre. Ka dëshmi mbi kontrollet e drejtuesve dhe mbikëqyrësve në kontrollin e gjendjes, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit racional të automjeteve. Kontrollet ditore para përdorimit nuk aplikohen rregullisht nga përdoruesit dhe ato neglizhohen. Formulari i përdorimit të automjetit (fletëudhëtimi) është hasur duke u përdorur në të gjitha automjetet e inspektuara dhe brenda tyre figurojnë informatat e nevojshme. Krahasuar me tre vite më parë, vërehet kujdes i shtuar në mbajtjen e pastërt të automjeteve dhe çmohet angazhimi i stacioneve në mbajtjen e higjienës brenda tyre. Inspektimi i realizuar pasqyron se stacionet nuk kanë automjete të mjaftueshme për të realizuar nevojat dhe kërkesat e tyre dhe kjo shtron nevojën e analizimit të gjendjes aktuale, shpërndarjes më adekuate dhe ngritjes së kapaciteteve aktive. Janë identifikuar edhe gjatë këtij inspektimi, raste të mosdeklarimit me kohë të defekteve duke rrezikuar ngritjen e kostove të mirëmbajtjes. Serviset rajonale vazhdojnë të mos jenë funksionale në masën e duhur në mungesë kapacitetesh të burimeve njerëzore, kurse mirëmbajtjet e lehta po vazhdojnë të kryhen nga ekipet mobile të Flotës Operative.

Në procedurën e mirëmbajtjes brenda Njesisë së Autoservisit nuk janë hasur dobësi lidhur me pranimin e automjeteve, caktimin e mekanikëve, hapjes së kartelave të punës, caktimit të komisionit inspektues, evidentimit të prishjeve, kontaktimit të deposë lidhur me pjesët, procedimin e automjeteve tek operatorët e kontraktuar, kontrollimit të automjetit pas kthimit, mbylljes së kartelës dhe dorëzimit të automjeteve. Kostot mbi shërbimet e operatorëve të kontraktuar shënojnë nivel shumë më të ulët krahasuar me disa vite më herët. Janë reduktuar vonesat në tërheqjen me kohë të automjeteve pas daljes nga procesi i mirëmbajtjes. Flota Operative ka në funksion Sistemin PRIMS, i cili në kohën e inspektimit ka pasur disa të meta dhe sanimi i tyre do ta bënte atë më funksional dhe në shërbim të kërkesave të strukturës policore. Dobësitë e PRIMS kanë vështirësuar gjenerimin e disa të dhënave mbi efikasitetin dhe performancën në procesin e mirëmbajtjes. Lidhur me kthimin e pjesëve të ndërruara në programet e mirëmbajtjes mbahet evidencë e veçantë, duke minimizuar mundësinë e keqpërdorimit të tyre. Depo e Flotës Operative mban

evidencë të dyfishtë mbi stokun e pjesëve rezervë dhe mbi pranimin e tyre mbahen regjistrat fizik të hyrje - daljeve dhe regjistri elektronik. Kostot në disa kategori shpenzimesh janë ulur krahasuar me disa vite më parë (gomat, pjesët rezervë dhe shërbimet kontraktuese), duke ngritë shkallën e ekonomizimit.

Me Procedurë Standarde të Operimit për Flotën Operative, përgjegjësia për njoftimin e zyrtarëve të mirëmbajtjes në stacione është hequr nga ZRS-ja dhe tanimë zyrtarët e tillë janë përgjegjës për të kryer me kohë kontrollet teknike dhe për të dorëzuar certifikatat tek ZRS-ja. Nga verifikimi i librezave të qarkullimit nga mostra 100%, është identifikuar se rreth 40% e automjeteve policore, regjistrimin e fundit e kanë kryer me vonesë dhe këto janë ndikuar në masë të madhe nga dështimi i procedurave në arritjen e kontratave për shërbime të sigurimit. Po ashtu, inspektimi ka vënë në pah se shumë nga automjetet gjatë periudhës sa kanë qenë të peregjistruara, kanë lëvizur dhe kjo është identifikuar nga një mostër prej 180 automjeteve të peregjistruara, ku 90 prej tyre vërehet se kanë lëvizur pa regjistrim.


Vitet 2017 e 2018 kanë shënuar numrin më të lartë të aksidenteve/incidenteve me përfshirje të automjeteve policore, të ndodhura në tetë (8) vitet e fundit. Në vitin 2019, lakorja e trendit të aksidenteve jep shenja pozitive drejt uljes së numrit të tyre. Punonjësit policor konsiderohen fajtor të aksidenteve në afërsisht 50% të rasteve dhe sipas të dhënave të Zyrës së Aksidenteve, nga 65% sa ishte në vitin 2017, bie në 58% në vitet 2018 dhe 2019, përqindja e rasteve të raportuara me vonesë të aksidenteve/incidenteve. Përqindja në rënie është inkurajuese, por nevojitet angazhim dhe seriozitet në raportimin me kohë të aksidenteve dhe incidenteve brenda afatit dhjetë ditor nga ndodhja e tyre. Faktori njeri vlerësohet të jetë shkaktari më i shpeshtë i aksidenteve dhe incidenteve dhe në tre vitet e fundit aksidentet më të shpeshta vlerësohet të kenë ardhur nga shkeljet e neneve 41 (veprimet me mjetin motorik), 53 (përshtatja e shpejtësisë) e 52 (lëvizja prapa) të ligjit në fushën e trafikut rrugor. Inspektimi i dosjeve me fajësi të zyrtarëve policor, ka gjetur se brenda tyre nuk janë duke u bashkëngjitur inicimet e brendshme disiplinore dhe nga një mostër prej 100% që lidhen me 469 raste të aksidenteve dhe incidenteve në tre vitet e fundit, diku 81% e dosjeve nuk kanë të bashkëngjitur inicimet e tilla. Janë hasur raste të aksidenteve kur fajtorë vlerësohen të jenë zyrtarët policor, dhe për të njëjtit nuk inicohen procedurat e parapara.

Nga verifikimi i pajisjeve rezervë apo shtesë të automjeteve dhe dokumenteve që duhet t'i kenë me vete ngasësit e automjeteve, vërehet se ka shumë mungesa të evidentuara, bazuar në Ligjin nr. 05/L-088 për rregullat në trafikun rrugor dhe udhëzimet administrative të hartuara nga Ministria e Infrastrukturës. Struktura policore duhet ngrisë nivelin e sigurisë për të përmbushur rregullat për pjesëmarrje në komunikacion, por duhet të krijoj kushte që zyrtarët e saj të mos bëhen shkelës potencial të rregullave, për të cilat shpesh gjobiten pjesëmarrësit në trafik. Nga pajisjet rezervë apo shtesë, në automjete më tepër vërehen mungesa të aparateve për fikje të zjarrit, kutisë së ndihmës së parë, dritave rezervë, mjetit për tërheqje në rast defekti dhe jelekëve reflektues. Kurse sa i përket dokumenteve, janë evidentuar mungesa të konsiderueshme të certifikatave të regjistrimit, polisave të sigurimit dhe raporteve evropiane të aksidenteve.

Rekomandimet:

Lidhur me këtë inspektim janë dhënë 13 rekomandime, qëi atribuohen gjetjeve. Me strukturën përkatëse policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Ky inspektim ka verifikuar edhe përmbushjen e rekomandimeve të inspektimit të kaluar dhe ka rezultuar se nga 12 rekomandime të lëna herën e fundit (inspektimi nr. 1/2017), dy (2) prej tyre janë përmbushur plotësisht, një (1) është përmbushur përgjithësisht, gjashtë (6) janë përmbushur pjesërisht, dy (2) nuk janë përmbushur dhe një (1) tjetër nuk është vlerësuar nga IPK-ja.



8. PLANIFIKIMI STRATEGJIK, ÇËSHTJET LIGJORE, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, PROMOVIMI DHE BASHKËPUNIMI

Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe si i tillë funksionon nga viti 2017.

Përgjegjësitë (detyrat) e këtij Departamenti janë: udhëheqë aktivitetet në nxjerrjen e planeve strategjike, bazuar në objektivat strategjike të Ministrisë, si dhe vlerëson zbatimin e planeve për përmbushjen e objektivave strategjike; siguron shërbime juridike/këshilluese ligjore për të siguruar menaxhim efektiv të rreziqeve ligjore dhe kontraktuale; udhëheqë aktivitetet për nxjerrjen, rishikimin - plotësimin e udhëzimeve, rregulloreve dhe PSO-ve lidhur me funksionet e IPK-së;

Udhëheqë me aktivitetet në zhvillimin dhe avancimin e bashkëpunimit e partneritetit ndër institucional brenda dhe jashtë vendit; udhëheqë aktivitetet e organizatës në ofrimin e shërbimeve profesionale në fushën e komunikimit dhe informimit publik; udhëheqë me aktivitetet për të siguruar realizimin e politikave në promovimin e vlerave, me qëllim të ngritjes së besimit dhe fuqizimit të rolit mbikëqyrës të IPK-së.

DPBÇLI zhvillon aktivitetin në dy (2) divizione:

- Divizionin për Planifikim dhe Çështje Ligjore;

- Divizionin për Bashkëpunim dhe Informim.

Departamenti ka të punësuar gjashtë (6) punonjës

IPK-ja gjatë vitit 2020 është angazhuar në përmbushjen e detyrave që kanë dalë nga

Plani Zhvillimor Strategjik 2019 - 2021 dhe detyra të tjera sipas nevojave. Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun, bashkëpunimit vendor e ndërkombëtar, planifikimit strategjik dhe çështjeve ligjore, IPK i ka realizuar përmes Departamentit për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim (DPBÇLI).

DPBÇLI është angazhuar në aspektin e planifikimit strategjik duke përgatitur Planin Vjetor dhe Planin e Veprimit, pastaj përgatitjen dhe azhurnimin e Listës së

DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM, BASHKËPUNIM, ÇËSHTJE LIGJORE DHE INFORMIM

Ne u angazhuam në sensibilizimin e qytetarëve për të shprehur përkushtimin tonë për trajtimin e shqetësimeve të tyre:

- Publikuam mbi 50 komunikata,
- Ofruam informacione për medie në mbi 250 kërkesa të tyre;
- Realizuar disa takime me qytetarë, forume të sigurisë, OJQ, institucione, etj;
- Hartuam dokumente planifikuese dhe akte nënligjore;

Analizës së Riskut për IPK-në, finalizimin e Procedurave Standarde të Operimit, etj. Angazhimet e DPBÇLI-së janë fokusuar edhe në fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë, institucione vendore dhe ndërkombëtare, transparencës institucionale etj.

Ky Departament ka shërbyer si ndërlidhës me Zyrën e Avokatit Shtetëror lidhur me disa procedura gjyqësore, ka bërë evidentimin, analizimin dhe interpretimin e vendimeve qeveritare për menaxhmentin e Inspektoratit Policor të Kosovës në funksion të zbatimit efektiv dhe efikas të këtyre vendimeve, posaçërisht të atyre që kanë qenë të lidhur me luftimin e pandemisë Covid-19 ka ofruar shërbime këshilluese juridike për punonjësit në IPK-së lidhur me aktivitetet e ndryshme të tyre etj.

DPBÇLI ka përpiluar dokumente dhe akte të ndryshme juridike për Inspektoratin Policor të Kosovës lidhur me menaxhimin e situatës së krijuar për shkak të pandemisë Covid-19 në përputhje me vendimet përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Bashkëpunimi me institucionet vendore

Në kuadër të bashkëpunimit vendor, DPBÇLI kanë pasur aktivitete me rëndësi në fuqizimin e këtij bashkëpunimi. Si pikë e kontaktit me institucionet vendore, janë trajtuar të gjitha kërkesat që kanë ardhur në adresën e IPK-së. Në bashkëpunim me departamentet e tjera, janë kthyer përgjigjet në MPB mbi raportimet për përmbushjen e objektivave strategjike të Planit të MPB-së dhe Qeverisë. DPBÇLI ka trajtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike, si dhe ka raportuar te Zyra e Kryeministrit mbi numrin e kërkesave të trajtuara.

Në kuadër të angazhimeve me institucionet e tjera, është ngritur niveli i bashkëpunimit me Avokatin e Popullit për fushën e të drejtave e lirive të njeriut. DPBÇLI ka trajtuar kërkesat që kanë ardhur nga ky institucion, respektivisht nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Janë trajtuar kërkesat e ardhura nga Avokati i Popullit, përfshirë edhe kërkesat për hapjen e rasteve sipas detyrës zyrtare.

Bashkëpunimi me Policinë është i orientuar në dhënien e kontributit për ngritjen e performancës së dy agjencive dhe ofrimin e ndihmës reciproke, teknike, operative dhe mbështetëse.

IPK bazuar në marrëveshjet paraprake gjatë këtij viti ka shfrytëzuar qasjet në sistemet dhe bazat e të dhënave policore për të kryer verifikimet e nevojshme, si dhe ka përdorur bazat e saj të të dhënave për të kryer verifikimet për nevoja të policisë (sidomos në rastet e promovimeve në grada).

Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun

Varësisht sipas nevojave operative në teren, në bashkëpunim me departamente të ndryshme në kuadër të IPK-së janë publikuar komunikata për media, janë organizuar takime ku janë pasqyruar rezultatet e arritura nga IPK-ja. Aktivitetet e deritashme që janë realizuar gjatë 2020-ës nga Divizioni për Bashkëpunim dhe Informim (DBI) në drejtim të fuqizimit të transparencës dhe bashkëpunimit me qytetarë kanë qenë:

- publikimi i rasteve që zgjojnë interesin e opinionit publik (kryesisht përmes komunikatave për media dhe prononcimeve;
- dhënia e deklaratave për mediet;
- angazhime shtesë në fushën e marrëdhënieve me publikun;

- përgjigjja në kërkesat e adresuara nga mediet e ndryshme në çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e IPK-së
- Kërkesat për qasje në dokumente publike etj.

Në kuadër të këtyre angazhimeve janë trajtuar me qindra kërkesa përmes telefonatave të ndryshme nga mediat, mbi 200 kërkesa me shkrim të adresuara në adresën zyrtare të DBI-së si dhe janë publikuar më shumë se 65 komunikata për medie lidhur me aktivitetet e ndryshme të IPK-së.

Përveç këtyre angazhimeve ky Divizion ka përgatitur në baza të rregullta analizën – raportin e shtypit ditor lidhur me ngjarjet që janë mbuluar nga mediat dhe i cili është shpërndarë te zyrtarët e IPK-së.

DBI ka administruar dhe ka përditësuar edhe rrjetet sociale me fokus të veçantë në Facebook-un zyrtar. Secila komunikatë e cila është përcjellë për publikim në ueb faqen zyrtare është publikuar edhe në Facebook duke rritur në këtë mënyrë edhe numrin e ndjekësve në këtë rrjet social.

Duke ju referuar situatës së pandemisë dhe vështirësive që qytetarët kanë pasur për qarkullim të lirshëm, Divizioni për bashkëpunim dhe informim me përkrahjen e ICITAP-it amerikan gjatë muajit qershor ka organizuar dhe marrë pjesë në disa emisione në televizione nacionale e lokale si dhe radio që kanë ndikuar në adresimin e ankesave të qytetarëve përmes formave të tjera si uebit zyrtar apo Linjës së kaltër.



Ndër temat që janë trajtuar në këto emisione me rastin e 14 vjetorit të institucionit dhe në prag të 5 vjetorit të hapjes së zyrave rajonale kanë qenë:

- Rrugëtimi i IPK-së ndër vite – historik i shkurtër;
- Roli dhe misioni i IPK-së;
- Funkionimi i zyrave rajonale (si mundësi shtesë për qytetarë)
- Angazhimet e zyrtarëve të IPK-së gjatë kohës së Pandemisë;
- Bashkëpunimi me qytetarë;
- Bashkëpunimi ndërkombëtarë;
- Rastet më të shpeshta që hetohen nga IPK-ja
- Integriteti policor;
- Linja e kaltër etj.

Në kuadër të këtyre angazhimeve janë organizuar dhe kemi marrë pjesë në emisione në RTK, RTK 2, Radio Kosova, RTV Dukagjini, RTV Besa dhe Radio Star etj.

Aktivite me qytetarë lidhur me misionin e IPK-së dhe integritetit policor e Linjës së Kaltër

Divizioni për bashkëpunim dhe informim në bashkëpunim me ICITAP-in amerikan, forumet e sigurisë dhe akterëve tjerë ka realizuar aktivitete të shumta në fushën e bashkëpunimit me qytetarët, duke prezantuar para tyre rolin, misionin dhe fushëveprimtarinë e IPK-së.

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) përmes Divizionit për bashkëpunim dhe informim në bashkëpunim me ICITAP-in amerikan ka realizuar aktivitete me studentët e Fakultetit të Sigurisë Publike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri.

Tema e trajtuar gjatë këtij aktiviteti/ligjërata në AKSP në Vushtrri ishte “Roli dhe rëndësia e integritetit të zyrtarëve policorë”.

Gjatë diskutimit të hapur me studentët u diskutua për integritetin policor, sfidat që përcjellin organizatat drejt fuqizimit të integritetit, kodin e heshtjes, ndërlidhja e integritetit policor me besueshmërinë e qytetarëve në polici etj.

Gjatë kësaj periudhe kohore DBI ka përcjellë kërkesën të Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – ARKEP që të bëhet aprovimi i vazhdimi për dy vite të Linjës së Kaltër si dhe numrit për tekst pa pagesë 50033 për qytetarët për të raportuar rastet e mundshme me elemente korruptive ose ankesave të tjera ndaj zyrtarëve policorë.

Aktivitetet e përbashkëta me misionin e OSBE-së, me forume të sigurisë (KLSP-të dhe EVSB-të) dhe zyrtarë të PK-së

Divizioni për bashkëpunim dhe informim në bashkëpunim me misionin e



OSBE-së (Sektorit për Zhvillim dhe Monitorim të Policisë) ka marrë pjesë si panelist në tetë punëtori të organizuara në muajin shkurt dhe mars në Prishtinë, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Mitrovicë e Jugut, Gjilan, Gjakovë dhe Prizren.

Pjesëmarrës në këto aktivitete kanë qenë anëtarët e Komiteteve Lokale për Siguri Publike (KLSP-ve), anëtarë të Ekipeve Vepruese për Siguri në Bashkësi, mbrojtësit e viktimave si dhe zyrtarë të PK-së.



Aktivitetet janë organizuar me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare rreth mbrojtjes së viktimave të mundshme të krimeve të urrejtjes.

Këto punëtori janë në vazhdimësi e aktiviteteve për të ngritur vetëdijen e qytetarëve rreth të drejtave të tyre në mekanizma mbështetës të

institucioneve përkatëse për mbrojtjen e viktimave respektivisht IPK-së. Gjatë punëtorive për pjesëmarrësit janë dhënë informacione lidhur me misionin dhe fushëveprimin e IPK-së si dhe projekteve si atij të hapjes së zyrave rajonale, Linjës së Kaltër, procedimit të ankesave, hetimeve etj.

Publikimi i revistës “Integriteti”

Ndër angazhimet e IPK-së në vitin 2020 për fuqizim të transparencës ka qenë edhe publikimi i revistës së rregullt “Integriteti”. Përveç informimit të brendshëm dhe atë kryesisht përmes shkrimeve të ndryshme të botuara në revistën zyrtare të IPK-së, kjo revistë konsiderohet si një projekt i rëndësishëm edhe për informimin e jashtëm e sidomos të zyrtarëve policor, partnerëve dhe qytetarëve për angazhimet e IPK-së.



Dhurimi i gjakut nga IPK - gjest human në situatë pandemie



Zyrtarët e Inspektoratit Policor të Kosovës edhe këtë vit dhuruan vullnetarisht gjak në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

IPK në këtë mënyrë iu përgjigj kërkesës së Qendrës Kombëtare për Transfuzion të Gjakut në lidhje me mungesën e dozave të gjakut në situatë pandemie.

Aksioni humanitar i dhurimit të gjakut u realizua në bashkëpunim me Qendrën

Kombëtare për Transfuzion të Gjakut në Prishtinë. Gjatë këtij aksioni një ditore janë dhuruar disa doza gjak për nevojat e Qendrës së Transfuzionit të Gjakut.

9.SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme ka rol mbështetës në menaxhimin e buxhetit, burimeve njerëzore, sistemeve të teknologjisë informative dhe shërbimeve logjistike në arritjen e objektivave të IPK-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e DFSHP-së janë: menaxhon dhe mirëmban informatat për burimet njerëzore të IPK-së, asiston menaxhmentin në organizimin e brendshëm, ofron mbështetje administrative, logjistike dhe të shërbimeve të teknologjisë informative, siguron zbatimin e procedurave për përzgjedhjen dhe punësimin e personelit të kualifikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi; koordinon përgatitjen, zbatimin, raportimin dhe vlerësimin e buxhetit të IPK-së; koordinon zbatimin me kohë të detyrimeve financiare të IPK-së; menaxhon sistemin e arkivit dhe dokumentet e brendshme të IPK-së; ofron shërbime logjistike për IPK-në; mirëmban pajisjet e TI-së dhe ofron shërbime të TI-së.

DEPARTAMENTI PËR FINANCA DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

Ofruar shërbime mbështetëse për funksionet operative të organizatës:

- Menaxhuam buxhetin e ndarë dhe realizuam 95.15% të tij;
- Vazhduam implementimin e projektit për digjitalizimin e Arkivës së organizatës;
- Pavarësisht situatës me pandeminë organizuam trajnime bazuar në Strategjinë e Trajnimeve të IPK-së,
- Menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së

DFSHP ka të punësuar 18 punonjës dhe është i strukturuar në tre divizione:

- Divizioni për Buxhet dhe Financa;
- Divizioni i Burimeve Njerëzore; dhe
- Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike.

DFSHP ka ofruar këto shërbime mbështetëse për funksionet operative të organizatës:

- Menaxhimin e buxhetit të ndarë i cili është realizuar 95.15%.
- Fillimin e realizimit të fazës së dytë të projektit kapital “Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit të IPK-së”.
- Menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së.
- Menaxhimin e pandemisë Covid-19 duke respektuar rekomandimet e IKSHPK-së dhe Vendimet e Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë.
- Realizimin e Planit të dalur nga Strategjia e Trajnimeve të IPK-së.

Tabela nr. 12: Buxheti Final dhe Shpenzimet 2020:

	Buxheti FINAL	Shpenzimi	Mbetja/Bu.	Shp./Bu.(%)
Paga dhe Shtesa	1,045,076.89	1,045,076.89	-	100.00
Mallra dhe Shërbime	290,878.61	226,535.15	64,343.46	77.88
Shpenzimet Komunale	4,699.62	3,887.23	812.39	82.71
Projekte Kapitale	59,889.00	57,100.96	2,788.04	95.34
Totali	1,400,544.12	1,332,600.23	67,943.89	95.15

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Inspektoratin Policor të Kosovës ka filluar fazën e dytë të projektit kapital “Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit të IPK-së” të planifikuar për këtë vit. Në këtë fazë të këtij projekti, ka planifikuar të bëjë edhe digjitalizimin e tërësishëm të Arkivit ku të gjitha lëndët arkivore përveç formës fizike të ruhen edhe në atë elektronike si dhe të krijohet një data bazë e avancuar për zyrën e Arkivit.

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme ka bërë menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së, ku në vazhdimësi ka trajtuar kërkesat për servisimin e automjeteve, ka hartuar autorizimet si dhe ka bërë sigurimin dhe regjistrimin e të gjitha automjeteve. Gjithashtu zyra e transportit ka bërë edhe inspektime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të flotës dhe po ashtu kanë krijuar kartelë fizike dhe elektronike mbi gjendjen e secilit automjet të IPK-së. Gjatë këtij viti, IPK ka arritur të shtoj flotën e automjeteve me gjithsej 8 vetura.

Inspektorati Policor i Kosovës ka hartuar “Planin e vijueshmërisë së punës gjatë Pandemisë Covid-19”, në përputhje me vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe rekomandimet e dala nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës - IKSHPK si dhe bazuar në



Pamje nga pranimi i donacionit me pajisje mbrojtëse Anti - Covid nga ICITAP-i Amerikan

MANUAL PËR MBROJTJE NGA PËRHAPJA E VIRUSIT COVID-19. Koordinatorin për mbikëqyrjen dhe implementimin e “Planit të vijueshmërisë së punës gjatë Pandemisë Covid-19, në IPK”, në të gjitha nivelet organizative të IPK-së, ka monitoruar zbatimin e masave mbrojtëse dhe sigurimin e ambienteve të shëndosha të punës për të gjithë pjesëtarët e IPK-së.

Fillimisht nga Ministria e Shëndetësisë jemi pajisur me: maska, doreza dhe dezinfektues për duar pastaj jemi furnizuar me pajisje anticovid nga MPB-ja si dhe donacione nga Ambasada Amerikane në Kosovë dhe

OSBE-ja.

IPK ka zbatuar rekomandimet nga **IKSHPK**-ja si: dezinfektimin e tërësishëm të objektit të **IPK**-së nga **MPB** dhe nga **KFOR**-i Italian, vendosjen e shenjave për respektimin e distancës dhe mbajtjes së maskave në të gjithë objektin, instalimin e aparateve për dezinfektim të duarve në hyrje të objektit si dhe në çdo hyrje të kateve përkatëse. Vazhdimisht është bërë shpërndarja e maskave, dorezave dhe dezinfektuesve për stafin e **IPK**-së si dhe duke u kujdesur që të respektohet mbajtja e distancës.

Sipas të dhënave në IPK mbi **20%** e stafit, që nga fillimi i pandemisë, kanë rezultuar pozitiv me COVID-19.

Trajnimet profesionale për stafin e IPK-së kanë qenë të reduktuara për shkak të pandemisë, edhe pse kanë arritur të mbahen disa të tilla kryesisht me përkrahjen e vazhdueshme të misionit të OSBE-së në Kosovë.

Tabelat në vijim prezantojnë numrin e trajnimeve dhe pjesëmarrësve në trajnimet për stafin operativ dhe atij administrativ të IPK-së.

Tabela nr. 13: TRAJNIMET/ STAFI OPERATIV				
Nr.	Emri i Trajnimit	Organi z	Muaji	zyrtar
1	Analizë e statistikave dhe të të dhënave	OSBE	Qershor	15
2	Trajtimi i provave të TIK-së ne vend ngjarje për IPK-në	OSBE	Shtator	12
3	Mashtrim Financiar	OSBE	Tetor/Nëntor	7
4	Monitorimi i besueshmërisë dhe knaqëshmerisë se publikut me PK-së	OSBE	Tetor/Nëntor	17
5	Mënyrat e duhura të shkëmbimit të Informacionit mbi incidentet e mundshme të motivuara nga paragjykimet	OSBE	Nëntor	2
Totali i punonjësve që kanë ndjekur trajnimet				53

Tabela nr.14: TRAJNIMET/ STAFI ADMINISTRATIV				
Nr.	Emri i Trajnimit	Organizatori	Muaji	Zyrtar
1	Çështje gjinore, politikat dhe praktikat bash kohore	IKAP	Mars	2
Totali i punonjësve që kanë ndjekur trajnimet				2



INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO



**NËSE MENDONI SE U JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA
NGA ZYRTARËT POLICORË, RAPORTONI NË *LINJËN E KALTËR*:
AKO MISLITE DA SU VAŠA PRAVA PREKRŠENA OD STRANE POLICAJACA
POZOVITE NA *PLAVU LINIJU*:
IF YOU THINK YOUR RIGHTS WERE VIOLATED BY POLICE OFFICIALS,
REPORT IN *BLUE LINE*:**

**RAPORTONI PA PAGESË
IZVESTI BESPLATNO U
FREE OF CHARGE**



080003333

**Së bashku për një polici profesionale
Zajedno za profesionalnu policiju
Together for professional police**

IPK SIGURON KONFIDENCIALITET TË PLOTË NË TRAJTIMIN E INFORMACIONEVE
PIK OSIGURAVA POTPUNU TAJNOST U TRETIRANJU INFORMACIJAMA
PIK OFFERS FULL CONFIDENTIALITY IN TREATING THE INFORMATION